

PJETER ARBNORI

BIBLIOTEKA

8JH-32

A74

KUR  
DYNDEN  
VIKINGET

NOVELE

Redaktorë:

ABAZ VEIZI  
SHEFKI HYSA

Piktor ALBERT YMERI

## PARALAJMËRIM

Sapo lexon titullin e librit «Kur dynden vikingët» të shkrimtarit Pjetër Arbnori, mendja të shkon menjëherë te dyndjet barbare qysh ndër kohërat më të lashta. Përfytyron jo pa dhimbje qytetërimi të tëra të zhdukura, popuj të zhbërë, raca e gjuhë të asimiluara. Vandalët të etur për zulmë, u kanë gllabëruar edhe shpirtin, jo vetëm materien pa mundur të njerëzohen kurrë, t'u ngjasojnë sado-pak atyre që mundoheshin të nënshtronin.

Po autori për ç'dyndje bën fjalë? Mos vallë për murtajën komuniste? Shënimi «Shkruar në burgun e Burrelit», qysh në krye si një nëntitull domethënës, të nxit mendimin se, në këtë libër, objekt i shkrimtarit rebel e kundërshtar i denjë politik i ish-diktaturës, duhet të jetë pikërisht ajo klimë ferri që zotëronte gjithë lindjen komuniste e në veçanti Shqipërinë. Mirëpo që në fjalinë e parë të kësaj novele përballesh me Rajhun e tretë të ish Gjermanisë naziste. Pra, është fjala për diktaturën hitleriane, një ndër modelet më të përkryera të makinave shtypëse antinjerëzore të tipit stalinist. Shpërngulja e ngjar-

jeve nëpër labirintet e Gjermanisë naziste, nuk është gjë tjetër veçse mesazhi i autorit i dërguar nga burgu i Burrelit për ngjashmërinë e krimeve të nazizmit dhe komunizmit në jetën familjare, shoqërore e politike. Madje, të zgjohet edhe kureshtja për të zbuluar raportin midis simbolikës dhe realitetit që bart në vetvete togfjalëshi «dynden vikingët». Pse jo «dyndeshin vikingët»? Ku e ka sekretin dhe epërsinë përdorimi i kohës së tashme të foljes «dynden», në krahasim me trajtën e së shkuarës që mund t'i përshtatej edhe periudhës së zhvillimit të ngjarjeve?

Ende vazhdojnë të dynden vikingët? Në ç'përmasa dhe cilat janë pasojat e dyndjeve?

Të mendojnë një copëherë të tilla pyetje, por shpejt harrohesh në një lexim tejet emocional para asaj hapsire të çuditshme që të shpaloset e gjallë ndër sy, si brigjet tunduese e ndjellëse të sirenavë të Odisesë apo si ishujt magjikë të Çirçeve ku më pas përjeton veç ankth, dhimbje, revoltë e tmerr për atë përçudnim njerëzor që të pret udhën.

Erna e hijshme flokëverdhe e sykaltër që magjeps edhe lexuesin, jo vetëm të shoqin, personazhin kryesor, me vështrimet dhe sjelljet e saj ku pas pasqyrimeve të gjireve të qeta shpirtërore fshihen trazimet e grackat e së keqes, është magjistaria e kohëve moderne. Vjen një cast dhe diku ngecet e nis të shplekset pëlhura e mashtrimit e endur gjatë në vegjen e padukshme të ndryrë nëpër skutat e ngrehinës — diktaturë.

Atëherë del fytyra e vërtetë e Ernave me tërë shëmtimin dhe përçudnimin, pabesinë dhe kurthet që bartin shpirtat e tyre të zinj. Atëherë s'ka se si të mos e vësh re përqasjen që autori u bën, përmes

realitetit hitlerian, diktaturave të të gjitha kohëve. Madje edhe ish diktaturës shqiptare. Vdekja mbetet e neveritshme dhe gjëmëzezë në çdo rrethanë, formë e mënyrë që të ndeshesh me të. Vdekja është vdekje edhe kur të vjen prej puthjeve të vampirëve si Erna, simotrat e së cilës i kemi hasur gjatë viteve të diktaturës komuniste. Për autorin diktatura nuk është thjesht një mekanizëm i verbër, por mendja e zezë dhe dora vrastare e demonëve si avokati fon Shvajcer, i besuari fanatik i partisë-shtet. Dogmat partiake — ideali i tij i vetëm, siç është figura e demonit sinonim i së keqes. Ai njëherësh si hije nuk ndodhet askund dhe ndodhet kudo. Madje edhe shpirti i Ernës, është hija e tij, mendësia dhe tërë veprimtaria e përfaqësuesve të ligjeve e të shtetit, nuk janë gjë tjetër veç pronë e tij. Jo pa dhimbje e ndrydhje të zemrës, pa rrënqethje të mishit, paralelisht me leximin e veprës, na vijjnë ndërmend tërë ajo gardë makabre partiako-shtetërore me sekretarët e partisë, aktivistët e spiunët e lagjeve e oficerët e sigurimit që arrinin gjer aty sa që e fusnin ndokënd në burg edhe pse e kish gruan të bukur. Pra, faqet e librit e zbulojnë dalëngadalë atë botë meskine, servile, prapaskeniste e njëherësh kriminale që rrafshon çdo vlerë njerëzore, botën komuniste të themeluar për gati 50 vjet edhe në Shqipëri. E ngjashme si dy binjakë me nazizmin gjerman-diktatura e kuqe. Me sa duket autori shënjon nazizmin e qëllon komunizmin, atë murtajë, që i mori rininë, familjen e gjithçka. Të joshte si kënga e sirenave, si pamja e mrekullueshme e Çirçeve dhe e tërë magjistareve, propaganda hitleriane apo ajo enveriane dhe pastaj ashtu si pakuptuar ta përdhoste moralin, ndërgegjen e po

të kundërshtojë të merrte dhe shpirtin nëpër katakombat e saj, siç veptoi edhe me autorin duke e përplasur burgjeve të zeza. Këtë «këngë» ndjellakeqe që shpërndan gjithandej jonet e vdekjes e ndien gjer në palcë kur lexon këtë vepër të Pjetër Arbnorit. Ndien gjithashtu edhe utë revoltë që duhet ta ketë frymëzuar aty në qelinë e errët kur ngjizte materialin jetësor për ta shndërruar në art. Kjo novelë tejet realiste me një ndjenjë të pakufishme humanizmi që ndoshta askush nuk e priste nga një i persekutuar si Pjetër Arbnori (30 vjet burg), tingëllon si një aktakuzë e fuqishme për të gjithë kohërat e diktaturave, të atyre që kaluan e që mund të vijjnë. Mjerë kulturat e qytetërimet botërore përballë diktaturave! S'janë asgjë dyndjet e lashta të vikingëve, në krahasim me rroposjet që shkaktojnë diktaturat e monstrat e tyre, vikingët e rinj. Vdiq nazizmi, ra edhe komunizmi në Shqipëri, mirëpo rreziku i dyndjes së vikingëve ende nuk ka rreshtur. Prandaj titulli i këtij libri është njëkohësisht edhe një kushtrim për vigjilencë: kujdes, o njerëz, ruhuni nga vikingët e kohëve moderne!


Vërtet me pak faqe kjo novelë, por për nga idetë dhe mesazhi është një vepër dinjitoze që të kujton «Fati i njeriut» e Shollohovit, «Shkretëtira Tatare» e Dino Buxatit, «Plaku dhe deti» e Hemingueit etj. Është si të thuash, një poemë për rezistencën e njeriut të nëpërkëmbur, të të gjitha kohërave, ndaj demonëve të natyrës apo të shoqërisë njerëzore. Njëkohësisht është edhe një sinjal i qartë që të jep të kuptosh se sa shumë ka humbur Shqipëria duke persekutuar talente të tilla si Pjetër Arbnori me shokë. Se mund të jenë me dhjetëra të tjerë

*ata që s'arritën kurrë ta thonë këngën e tyre, nga ferri i birucave, goftë edhe të vonuar.*

*Në fund të fundit ky libër është një befasi e këndshme dhe një fillim i suksesshëm që paralajmëron një ndihmesë të madhe, jo thjesht për lavdi vetjake të autorit, por në shërbim të kombit.*

*Lexim të mbarë të nderuar lexues!*

**SHEFKI HYSA**





## Fashizmi dhe komunizmi janë vëllezër.

NEHRU

**K**ur u shemb Rajhu i Tretë, më qëlloi të shërbeja në Komisionin mjekësor që kujdesej për të sëmurët dhe të degraduarit e kampeve të përqëndrimit. Për ata që kishin shpëtuar gjallë. Ndër të liruarit e shtruar në spital më tërhoqi vëmendjen një burrë i gjatë, kockë e lëkurë, me sy gjithmonë të shqetësuar. Nuk vuante nga asnjë sëmundje e dukshme, megjithatë ishte më rëndë se të tjerët. S'i përgjigjej asnjë pyetjeje, nuk arkohej për asgjë, nuk shprehte asnjë dëshirë. Donte vetëm ta linin rehat, mos ta bezdisnin me fjalë. Një mbrëmje kur isha roje nate dhe i kisha kryer të gjitha punët, u ula te koka e tij. Pa i folur gjysmë fjale, i fërkova një copë herë ballin. Bëja sikur s'e vija re shtrëngimin e nofullave dhe armiqtësinë që i përshkëndiste sytë. Ai u mbajt e u mbajt dhe kur s'e prisja u zbut e shpërtheu në lot. Mbasi u qetësua zuri të më rrëfente historinë e jetës së tij...



«Kam shërbyer si oficer i Rajhsverit<sup>1</sup> dhe më vonë i Vermahtit<sup>2</sup>, që kur se jam bërë burrë. Kam

---

1) Rajhsver (Reichswehr) — kështu quhej ushtria gjermane pas Luftës I Botërore.

genë shef i shtabit të mbrojtjes civile në Frankfurt mbi Majn. Isha i martuar, me dy fëmijë: një djalë e një vajzë. Quhem Karl Landau. Jam nga krahira e Saarës, po ashtu edhe gruaja ime. Historia e martesës sime është e veçantë, prandaj do ta tregoj që në fillim.

Shumë vjet më parë në bazë të Traktatit të Versajës, vendlindja ime, Saara iu la për pesëmbëdhjetë vjetë Francës. Veç asaj i gjithë bregu i majtë i Rinit u pushtua nga Antanta, duke përfshirë edhe qytetet Këln dhe Mainc. Në bregun e djathtë u krijua një zonë e çmilitarizuar; Gjermania detyrohej të paguante 132 miliard marka ar si dëmshpërblime lufte. Mbante edhe ushtritë pushtuese. Mund të mbante një ushtri prej 100 mijë vetësh dhe ndalohesh të prodhonte armatime të rënda! Ndërsa na predikonin çdo ditë se na çliruan nga tirania e Kaizerit, aleatët nisën të na rjepin vetë. Dhjetëra trena ngarkuar me qymyrguri, hekur dhe lëndë të tjera të para nisën të kalonin kufirin për në Francë. Ndërkaq vetë Gjermania ishte gërmadhë. Varfëria dhe papunësia kishin arritur kulmin. Bashkë me to rritej edhe reaksioni ndaj pushtuesve. Kudo nisën sabotimet. U krijuan shoqatat «Helmetat e çeliktat» (Stahlhelm) dhe «Viking». Unë aso kohe isha kursant në akademinë ushtarake dhe bëja pjesë në shoqatën e parë.

Në vitin 1922 erdhi në akademi një djalosh i panjohur dhe kërkoi të bisedonte me mua. Quhej Arnold Kirshe. Ishte nga krahina e Saarës, sikurse

---

2) Vermaht (Wehrmacht) – kështu quhej ushtria gjermane gjatë sundimit nazist.

unë. Vendlindja ime ishin rrethinat e Folklingenit, ndërsa ai nga një fshat i Sulcit, disa orë më larg.

Mbasi më dëftoi disa rekomandime të besueshme, m'u hap. Tha se vinte nga shoqata «Viking», e cila më ftonte të ndihmoja në veprimtarinë e saj sabotuese, në krahinën e Saarës. Isha djalë i ri asokohe, djalë i nxehtë. Kuptohet që i shikoja shtrembër pushtuesit dhe do të dëshiroja t'i shihja tek thyenin qafën për në verdin e tyre. Dhe ja ku erdhi Arnold Kirshe dhe më foli për ato që më vlonin në zemër, por që s'dija si t'u jepja udhë. Ai ma kthjelloi e ma ndriçoi mendjen aq mirë, saqë, me takimin e dytë, pranova. Kuptohet që transferimin e bëra me miratimin e Shtalhelmit.

Në Saarë gjeta një rrjet të organizuar mirë që mbliidhte informata, vinte zjarre, nxirrte trenat nga shinat, gjithnjë duke u kujdesur që të mos binte shumë në sy. Kuptohet, njihja vetëm Arnold Kirshen dhe bashkëpunëtorët më të afërt. Komandant i shoqatës për Saarën, më kishin thënë se, ishte një njeri i tmerrshëm, që, po ta donte puna, hante francezë të gjallë. S'e njihja për fytyrë, por mësova se quhej Vikingu i Madh.

Filloi kështu për mua një jetë sa e rrezikshme aq dhe e bukur. Nuk m'u desh shumë kohë për të kuptuar se shumë djem, më të mirë e më të zotë, ishin bashkuar me çështjen tonë. Më i miri i të gjithëve ishte Arnoldi, të cilit i prija nëpër shtigjet më të parrapura të kufirit franko-gjerman.

Një ditë ai më njohu me Erna Volden, me vajzën e një fermeri të krahinës së tij. Edhe ajo e adhuronte Arnoldin. Çdo fjalë a gjest i saj, sado që përpiquej ta fshihte rrezatonte admirim. Me të marrë vesh se shoku i saj i kishte hyrë një jetë plot rre-

zique. Erna kishte shprehur dëshirën ta ndihmonte edhe vetë. Të vinte çudi se si ajo ëngjëllushe flokëverdhë e sykaltër, kishte gjithë atë energji e guxim. Për muaj me radhë ajo, jo vetëm që s'na u nda asnjë hap, por kryente edhe detyrat më delikate. Shpesh ktheheshim te shtëpia e Arnoldit, në Cvajbryke. Aty, nëna e tij, Helena, një grua e rrefkët po shtatlidhur, nënë e dashur dhe gjermane e mirë, mbasi ia gëzonte flokët vajzës, na porosiste të kujdeseshim për nusezën e saj. «Mos e sillni kokën po i ngjau gjë asaj»!

Një ditë na erdhi urdhëri nga Vikingu i Madh që ta transferonim fushën e veprimit, përtej kufirit, në Francë. Pushtuesit nuk ishin budallenj. E kuptonin se gjithë ato raste sabotimi nuk ishin spontane, por fryt i një pune të organizuar mirë. E kërcënuan qeverinë gjermane se po pengonte me qëllim pagimin e reparacioneve. Kështu që ne duhej t'u përshtateshim rrethanave, të vepronim në tokën e armikut.

Unë s'kisha njeri në fshatin tim për t'i lënë lamtumirën. Shtëpinë dhe një vreshtë timen ia kisha lënë një kushëri të largët, të kujdesej. Motra ime e vetme ishte e martuar në Këln. Shkuam tek nënë Helena për t'u çmallur disa ditë. Ishin Krishtlindjet e vitit 1922. Të mësuar vazhdimisht me kokën në torbë, s'na zinte vendi-vend. Por punët u rrokullisën ndryshe. Kryetari ynë i tmerrshëm edhe pse mund të hante francezë të gjallë, për shokët e tij ishte zemërdhembshur dhe vigjilonte ditë e natë. Ne s'e njihnim por ai na njihte një për një. Në fillim të janarit Vikingu i Madh solli urdhrin që kurrsesi Arnoldi dhe Erna të mos e rrezikonin kokën bashkë. Njëri prej tyre, me dëshirën e vet, duhet të

qëndronte në Saarë në dispozicion të shtabit. Kup-tohet, vendosi të shkonte Arnoldi, përtej, sadoqë Ernës nuk i erdhi mirë.

Më 12 Janar 1923 ushtritë franceze pushtuan zemrën e industrisë gjermane, krahinën e Ruhrit, me pretextin se Gjermania nuk po dorëzonte qymyrgurin dhe lëndën e drurit. Unë mora urdhërin të kaloja menjëherë në Ruhr, qindra kilometra në veri, në shërbim të shoqatës sime Shtalhelm, ndërsa Erna do të merrte detyrën në shtab, në Saarbrücken. Brenda një nate po ndaheshim në tre drejtime të papritura. Nënë Helena na bekoj dhe nuk na foli nga ato fjalët e mërzitshme që thuhën në raste të tilla. Arnoldi ma shtrëngoi dorën fort dhe tha se po t'i ndodhte gjë atij, Ernën ma linte amanet mua. Qesha dhe i thashë se për amanete isha unë, që po ikja aq larg, ndërsa ata do të takoheshin, të paktën, çdo javë. Por Arnoldi ia përsëriti edhe s'ëmës se Ernën ma linte amanet mua. Dhe u ndamë.

Në gjithë Gjermaninë filloi periudha e famshme e «Rezistencës Passive». Ishte koha kur gjithë punëtorët gjermanë u bënë «milionerë» dhe «miliarderë», por edhe kur një pjatë patate kushtonte tre milionë marka dhe një biletë trami 100 mijë marka. Vërtet vuajtëm, mirëpo pushtuesit nuk morën dot as qymyrin, as çelikun që dëshironin. Pata aq shumë punë atë vit sa s'vajta dot asnjëherë në Saarë. Korrespondencë me Kirshet nuk mund të mbaja. Megjithatë zërin e mirë ia dëgjoja, herë pas here Arnoldit. Ishte më e perceptueshme veprimtaria e tij konkrete, para bëmave imagjinare të Vikingut të Madh...

Në gusht mora vesh gjëmën e madhe. Duke lexuar gazetën mësova se Arnold Kirshe, i kërkuar aq

shumë prej francezëve, ishte vrarë poshtë fshatit të vet, Cvajbryke, afër stacionit të trenit. Të nesërmen, në mbrëmje, një tjetër ilegal i rrezikshëm, i quajtur «Vikingu i Madh», kishte ardhur me njësitin e vet në stacion, kishte djegur shtëpitë e Baumanëve, tregtarë e çifutë vendas, dhe kishte therur tre meshkuj prej tyre, duke i akuzuar si bashkëpunëtorë të francezëve dhe hjekës në vrasjen e Kirshes. Autoritetet franceze, thuhej në gazetat, kishin lëshuar një urdhër për arrestimin e të vetëquajturit Viking i Madh, por ai kishte fluturuar në Zvicër.

I hipa trenit dhe vajta në Cvajbryke. Nënë e shokut e gjeta në të zeza. Më vjen turp ta them por unë qava kur e përqafova, ndërsa ajo s'nxori pikë loti. Ajo m'i shpjegoi disi më qartë rrethanat e vrasjes. Arnoldi po përcillte në qytet Vikingun e Madh. Gjysmë ore poshtë fshatit, tek stacioni, e kishin goditur nga shtëpia e Baumanëve. Në pushkët e para Arnoldi kishte mbetur i vrarë. Vikingu e kishte marrë shokun në kurriz dhe varrosur në një koriye. Të nesërmen në darkë kishte bërë hakmarrjen e tmerrshme mbi Baumanët. Për të gjitha i kishte dërguar lajm nënë Helenës, duke e ngushëlluar për humbjen e hidhur.

Derëshuara Kirshe më shpuri të varri i ri. Më tha se i vetmi merak i saj ishte që s'e kishte parë të birin e vdekur dhe s'ia kishte puthur plagën në ballë. Poshtë nxinin gërmadhat e shtëpisë së Baumanëve. U ula dhe putha dheun e freskët. Për të dytën herë u përlota.

— Bëhu i fortë! — më qortoi nëna. — Keni ende punë për të bërë. Arnoldi nuk do të flerë i qetë, po s'kryet edhe detyrën e tij.

U kthyem përsëri në shtëpinë e saj.

— Nënë Helenë, — e pyeta derëshuarën, — ku e merr këtë fuqi sa të më gjallërosh edhe mua?

— Ditën e gjëmës o bir, po ta çash zemrën e nënës do ta gjesh krejt të bardhë. Vetëm në mes do të dallosh një pikë të zezë. E zeza është humbja e djalit, e bardha është ngushëllimi që ndien nëna, duke parë se i biri paskësh pasë miq e shokë që pikëllohen për humbjen e tij. Po të hapësh, po atë ditë, zemrën e miqve e dashamirëve, ajo është sterrë e zezë nga humbja e shokut. Kështu i ishte bërë Vikingut të Madh që theri dhe shkrumboi Baumanët; kështu të është bërë ty që s'i mban dot lotët, edhe më zi Ernës që po vdes nga hidhërimi. Pastaj, duke kaluar ditët, ajo pikë e zezë zmadhohet e zmadhohet derisa, në pleqëri, përfshin gjithë zemrën e nënës, ndërsa po të kesh mundësi ta hapësh zemrën e mikut, mbas një muaji, një viti a dhjetë vjetësh, do të vësh re se e zeza zbutet e zbutet derisa zhduket fare, ose mbetet sa ajo pika që kam unë sot. Mos ma merr për të keq, këtë që të thashë, Karl. Kjo është njerëzore. Bota është e madhe dhe ju duhet të jetoni. . .

Sado që më tingëllonin keq, unë s'qesh i zoti të kundërshtoja asnjë nga fjalët e saj.

— Erna është molisur fare, — vazhdoi ajo, duke kuptuar një pyetje që më kishte mbetur në buzë. — Qëndron e fshehur te disa kushërinj në një fermë të largët. . . U përpoqa ta marr në shtëpi, por s'u bind kurrsesi. Më tha se e njohin nga këto anë, por unë e di se e vërteta është ndryshe. Ajo nuk vjen sepse ka përballë vendin ku ndodhi tragjedia e jetës së saj. Sa herë shkoj ta takoj e gjej duke qarë me dënësë. Tani po pret lidhjen që t'i futet punës dhe një herë. Dhe sa më shpejt t'i

vijë, aq më mirë, ndryshe do të vdesë nga e keqja. Tani për tani mos shko ta takosh, por përpiqu e rregullo punën që të vish prapë këndeje me detyrë. Do të jetë më mirë edhe për mua, edhe për vajzën. Mos harro se e ke amanet nga im bir.

I premtova se do të përpiqesha të bëj si më tha e u ndamë.

Shtatori që muaji i turbullirave të majta në Gjermani. Papunësia e varfëria i kishin acaruar shumë masat punëtore. Komandanti i Rajhverit, gjenerali fon Zekt, në këto rrethana vendosi të ndërpriste «rezistencën pasive» dhe mori masa për gjallërimin e përgjithshëm të ekonomisë së vendit. Sabotimet pushuan. Unë u emërova oficer në njësitë e Rajhsverit. Mora një muaj leje para se të filloja detyrën.

Tashti varri i Arnoldit ishte rregulluar me gurë graniti të gdhendur dhe te kryqi kishte lule të freskëta. Plaka më tha se Erna bëhej një muaj e larguar nga Saara dhe ende s'kishte dërguar lajm se ku gjëndeje. Ato ditë në fshat dëgjuam për grushtin e shtetit të 8 Nëntorit 1923 që bëri Adolf Hitleri, në Mynhen. Puçi dështoi shpejt: shumë vetë u arrestuan, të tjerë u arratisën në Zvicër. Ndër të arratisurit gazetat përmendnin edhe «Vikingun e Madh» atë komandantin tonë që të merrte gjak në vetull.

Pa u mbushur java, ia behu Erna Valde, në Saarë. Shkuam e takuam bashkë me nënë Helenën në fermën e saj. Ata tre muaj vajza ishte tretur si qiri, por, nën rrobat e zeza, kaltërsia e syve dhe ari i flokëve e nxirrnin më ëngjëlore. Një dëshpërim i thellë lexohej në ata sy. Ajo na tha se tashti që kishte dështuar grushti i Mynhenit, ishte shuar



çdo shpresë për të nisur nga e para. E ëma, një grua e sertë, iu ankua Helenës, se edhe po të shpëtonte nga thonjtë e francezëve, e bija do të vdiste nga kujtimi i Arnoldit të ndjerë, varri i të cilit i fanitej gjithnjë në ëndërr.

Kur u ngritëm të iknim, nëna e shokut më pyeti mënjanë:

— Po Erna?

Unë ngrita supet i pafuqishëm.

— Po ai ta ka lënë amanet!

Sa s'më vajti dora te portofoli, por më shpëtoi zoti pa e bërë atë gjest fyës.

— Ajo do një njeri që ta ketë kujdes dhe t'i bëhet krah, — shtoi. — Tek unë s'dëgjon të vijë se ka varrin e të shuarit gjithnjë para syve. Vëllanë e ka të vogël.

— Po sikur ta çojmë tek ime motër, në Këln? — thashë.

Dy gratë u kthyen dhe e biseduan një grimë herë, derisa ia mbushën mendjen vajzës. Mbas disa ditësh, kur na përcollën, dy gratë na puthën në ballë dhe nëna e Arnoldit tha:

— Qofshi bekuar bijtë e mi! Shpresoja ta marr nuse në shtëpi, por, edhe tek e shoh përkrah teje, më duket sikur është me tim bir.

Më erdhi ligsht nga ato fjalë, por m'u duk më e arsyeshme të hesht.

Unë nisa detyrën në Frankfurt mbi Majn dhe s'i pashë për shumë muaj. Po kur u mbush viti i vdekjes më thirrën me telegram te motra në Këln. Atje gjeta nënën e Arnoldit dhe nënën e Ernës. Sadoqë ishte ende, e hequr në fytyrë, dukej që vajza e kishte marrë veten. Rrinte gjithnjë syulur kur fliste me mua. Dy gratë më thanë se i

kishin biseduar të gjitha hollësitë me time motër dhe tashti s'kisha ç'prisja tjetër, veç të vija kurorë me Ernën. U trondita nga ajo e papritur, por s'e dhashë veten në sy të saj. Bisedova veç e veç me gratë dhe ato ma mbushën mendjen se mund ta merrja pa më vrrarë ndërgjegja. Dhe kështu u martuam.

Ditën e parë kur e shpura në apartamentin tim, në Frankfurt, sa pa fotografinë e Arnoldit në dhomën e fjetjes, u shkreh në vaj. M'u desh një copë herë që ta pajtoj. Kur ngriti, më në fund, sytë e bukur m'u lut me të dridhura:

— Hiqe atë!

— Përse?

— Nuk ka kuptim të qëndroni të dy në këtë dhomë. Tashti ti je burri im, kupton?

E hoqa pa dëshirë. Atë mbrëmje e kuptova shkakun e shqetësimit të saj. E gjeta Ernën ndryshe nga ç'e prisja dhe u habita për ngutjen e shokut tim. Por s'kisha pse të bëhesha xheloz ndaj të vdekurit, aq më tepër kur e dija se ata duheshin në heshtje.

Shumë vjet qemë të lumtur. Duheshim pa masë. Kishim dy fëmijë si pëllumba, Fricin dhe Lizën, leshverdhë e sykaltër si unë dhe Erna. Ndryshe nga ime shoqe, nuk u përzjeva më me ngjarjet politike, meqenëse puna e oficerit më dukej më se e mjaftueshme për të kryer detyrën ndaj atdheut. Mbas ardhjes së Hitlerit në fuqi, edukata fizike ushtarake u fut me detyrim në të gjitha shtresat e popullsisë, që nga studentët universitarë deri tek punëtorët e fabrikave. Këtë punë e drejtoja dhe e kontrolloja unë, në qytet. Nënë Helenën s'e harrova kurrë: herë e ftoja, herë veja vetë në Saarë. Por

ajo ngrysej nga viti në vit dhe nuk shkulej nga fshati se kishte pranë kujtimin dhe reliket e të birit: edhe mua vitet e fundit rrallë e më rrallë më binte rruga andej.

\*  
\*   \*  
\*

Jeta jonë rridhte e qetë dhe e këndshme. Por vitin e fundit ndodhi një ngjarje e vogël, që, pastaj, si ortek bore erdhi duke grumbulluar gjithçka rreth meje, deri sa më shembi në greminë bashkë me iluzionet për jetën e shoqërinë.

Një ditë erdhi për vizitë vëllai i Ernës nga Saara. E kisha lënë të vogël, tani ishte rritur e fejuar. Dëshironte të vendosej në Frankfurt bashkë me nusen e re dhe për këtë donte të këshillohej me mua. Duke pyetur për vendlindjen time dhe të njohurit e atjeshëm, së pari u interesova për nënë Helenën. Sa çudi më erdhi kur burri i ri përvoli buzët dhe tha se ajo nuk ishte në terezi. Pas këmbënguljes sime ai na tregoi se marrëzia e saj nisi ditën e heqjes së eshtrave prej pyllit për në varrezat e qytetit. Me rastin e bartjes së eshtrave të luftëtarëve të vrarë për Gjermaninë, që ishte bërë dy javë më parë në varrezat e posaçme në Saarbrykes, plaka lajthiti fare. Kishte ardhur duke mbajtur për dore një fëmijë Baumanësh. Kjo kishte shkaktuar përshtypje të keqe, pakënaqësi të autoritetet e mbledhura dhe të shokët e të birit. Ishin përpjekur t'ia shkëpusnin fëmijën çifut nga dora, por plaka nuk epej. Atëherë ishin detyruar ta largonin nga arkivoli që mbante eshtrat e të birit, për të shmangur skandalin.

— Erna, mos na ka ardhur ndonjë ftesë dhe e ke harruar?! — pyeta time shoqe. — Në kësi ceremonish është zakon të marrin pjesë të gjithë bashkëluftëtarët e të rënëve.

— Edhe të na kish ardhur ftesa, ti para dy javësh ishe i zënë me lojën e korpusit, — tha ajo.

— Ka leje për këso rastesh, — ia ktheva, — le që duhet të kishe shkuar ti, të paktën.

— Sigurisht, sigurisht, — belbëzon ajo, — po ja që unë s'di gjë.

— Ç'i qenka tekur asaj së shuarës të plekset me ata Baumanët, — thashë, po dhe vetë u skuqa kur fola.

Një vit më parë, tek po shqyrtoja dokumentat e studentëve të universitetit, në zyrën ushtarake, ndesha një Brauman nga Saara. I malluar për bashkëvendësit e mi, u interesova të di më tepër për të dhe ta njoh nga afër. Po djaloshi kur m'u paraqiti në zyrë, dukej shumë i topitur dhe iu përgjigj me belbëzime pyetjeve të mia. E kuptova menjëherë se ishte një Bauman që i kishte shtuar një «r» llogarit për t'iu shmangur përndjekjeve. Baumanët ishin vrrarë e ishin djegur për hjekësinë që i kishin bërë Arnold Kirshes. Ata që mbetën gjallë kishin dashur të ngrinin përsëri shtëpitë e djegurat, por banorët e stacionit Cvajbryke i kishin penguar. Nuk qeshë dhe unë pa gisht në këtë punë. Dëshiroja që nënë Helena veç varrit të të birit, të kishte çdo ditë para syve, për ngushëllim, edhe rrënojat e nxira të armiqve. Edhe telashe të tjera u kishin nxjerrë Baumanëve, aq sa dy burrat e fundit ishin detyruar të arratiseshin. Por tani që kishin mbetur veç femra e çiliminj, s'kishte hije të merreshe me ta. Dhe ja ku kisha përpara një

Bauman të saporritur. Turp për mua, por më erdhi keq për të. Fundi i fundit ç'faj kishte ai për poshtërsinë e prindërve? Ai kish qenë kalama kur kish ndodhur mynxyra. Pyeta për të e më thanë se ishte më i miri i kursit. Çudi, kisha dëgjuar edhe më parë se të gjithë të përndjekurit, pa bursa, pa përkrahje, merrnin shumicën e çmimeve të para në shkollat tona. Mbylla sytë dhe bëra sikur s'e njoha...

Erna shkoi të binte para kohe se i dhimbte koka. Kur vajta edhe unë, më vonë, e gjeta të zverdhur e pa gjumë. Gjithmonë, kur dikush përmendte të ndjerin, ajo sëmurej. Mua nuk më mbetej hatri se e dija sa më donte. Ishte një dobësi e vjetër dhe aq.

— Të kesh dhembje për të mundurin, kur ai s'të dëmton dot më, është fisnikëri, por veprimi i nënë Helenës më duket pa kuptim, — i folta.

— Është sfidë! — tha ime shoqe, — duhet ta ketë shtyrë dikush!

— E kush ta shtynte? Kundër të birit?!... Do të interesohemi si është puna. S'duhet të jetë kaq e thjeshtë.

— Mos u fut në ato punë. I shkruaj unë nënës sime dhe na e sqaron ajo çështjen.

Me atë rast i tregova Ernës edhe për çështjen e Baumanit të ri që kisha zbuluar në kartelat e universitetit.

— E përjashtuan?

— Jo, i thashë; — ishte studenti më i mirë i fakultetit dhe unë s'bëra zë.

Ajo psherëtiu.

— Javën tjetër do të nisem në Saarë — vazh-

dova unë. — Do të sqaroj përse s'na kanë ftuar në ceremoni, do të vizitoj nënë Helenën e të pyes si është puna.

Tri ditë më pas, komandanti i qarkut ushtarak, brigadenfyhri Shtaube më lajmëroi se kërkoheshin urgjent në Berlin. U bëra gati dhe kur dolëm me Ernën për të shkuar në aeroport, te shkallët e pallatit ndeshëm një fytyrë të shëmtuar që s'e njihja. Ime shoqe u rras tek unë dhe unë pas murit. Ai na përshëndeti me njerëzi, por kur u përpoq të na buzëqeshte u përçudnua edhe më:

— Cili është ky? — pyeta Ernën.

— Një banor i ri i pallatit. Pardje zuri apartamentin e lirë një kat poshtë nesh. Më erdhi të rrëqethur kur e pashë. Seç ka diçka që të kall një tmerr të pashpjegueshëm — tha ajo duke më shtrënguar krahun.

U paraqita në Ministrinë e Luftës. Ata më ngarkuan me një detyrë inspektimi në Prusinë Lindore. Kur u ktheva pas një muaji, gruaja dhe fëmijët m'u hodhën në qafë, kaq ishin malluar për mua. Më lanë pushim një javë megjithëse s'kisha pasur asnjë lodhje gjatë asaj shëtitjeje mujore.

— Po sikur të shkonim të gjithë bashkë në Saarë? — u propozova nga fundi i javës.

— Si të duash, — tha Erna pa qejf.

Pa mbaruar pushimin, erdhën e më thirrën nga komanda se kish ardhur një ekip kontrolli. Puna jonë e tillë është, nuk je kurrë zot i vetes, as ditën, as natën.

Sallën e mbledhjeve të universitetit e gjeta plot studentë, profesorë, ushtarakë. Sa e madhe qe çudia ime kur në tribunë doli avokati fon Shvajcer,

fqinji i ri i pallatit tonë. Ai ishte i njohur jo aq si jurist se sa si politikan i prapaskenave. Ia kisha parë emrin ndër gazeta. Flitej se ishte një nga «miqtë e tavernës së Augsburgut», pra i lidhur ngushtë me qarqet e larta naziste. E kisha takuar gjithsej tri herë. Ishte gjithmonë vramuz. Ime shoqe s'mund ta shikonte dot me sy.

Tema e fjalimit të tij qe fushata kombëtare antisemite. Fliste prerë, rreptë, kthjellët dhe gjykimet e tij të nguleshin si gozhdë në tru. Foli për pastriemet në institucione, fabrika, qytete. Pastaj u ndal te rastet e pavëmendjes dhe nënvlerësimit. Dhe, kur s'e prisja, më sulmoi drejtëpërdrejtë mua që gjende-sha në radhën e parë të sallës. Më akuzoi se kisha vistuar dokumentet e një Baumani që ndiqte kursin e fizikës teorike në universitet, sadoqë ishte çifut, vrasës i gjermanëve dhe bashkëpunëtor i francezëve. E humba gjakftohtësinë dhe iu përgjigja rëndë. Dhe i rëndoja fjalët sa më shumë e kuptoja që kish një farë të drejte.

Dilte fon Shvajceri nga anë e anës dhe më sulmonte mua, duke thënë se kisha shkelur me këmbë gjakun e shokut! Dhe tre-katër oficerë kolcë të mi, u ngritën e i mbanin anën e tij.

U ktheva në shtëpi i xhindosur dhe i tregova Ernës çfarë kishte ndodhur. Ajo u tremb aq fort, sa më luti me lot në sy, të mos ngatërrohesha me të. Dhe s'më lëshoi të dilja, deri sa më mori fjalën. Më mbushi mendjen gjithashtu të mos e bëja udhëtimin e planifikuar në Saarë, se takimi me nënë Helenën në këto rrethana, tingëllonte si marrëveshje.

— Po jam i pastër, më kupton?! Jam i pastër! — protestova. — Kjo do të thotë ta bësh veten fajtor me zor.

— Dëgjomë mua, po ndjenje larg atyre ngatërrsave, s'të gjen gjë për njëqind vjet — ngulte këmbë ajo.

Fon Shvajcerin e kisha halë në sy pas asaj ngjarjeje. Po për fat e pashë vetëm një herë nëpër shkallë. M'u kujtua fjala që i kisha dhënë gruas dhe e shumta që bë më, nuk u përshëndetëm dhe ai iu rras murit e unë parrmakëve që të mos cekeshim me bërryla.

Për fat avokati nuk u duk më në apartamentin e vet që qëndronte gjithmonë i mbyllur dhe me grila të ulura. Punët e shumta e kërkonin nëpër gjithë Gjermaninë në atë periudhë të rrëmbyer. Madje, s'e kuptoja përse e mbante atë apartament derisa ndejën e kishte në kryeqytet. Sa herë binte fjala për të, ime shoqe përsëriste shpesh se fytyrë më e përçudnuar dhe tipare më shtazore se të tijat, zor se mund të gjendeshin në botë.

Kuptohet që Braumanin e përjashtuan. Një muaj më vonë u emërova shef i shtabit të mbrojtjes civile të Frankfurtit, detyrë e rëndësishme, por dhe që s'të linte të merrje frymë. Tamam, ashtu siç e dëshiroja unë. Më qëllonte shpesh të ikja me shërbim për disa ditë. Kur kthehesha djali e vajza më hidheshin në qafë. Gruaja mërzitej shumë nga mungesa ime dhe më priste me padurim. Gjithnjë më lutej të mos flija jashtë shtëpisë. Erna më donte shumë. Shkonim mirë, kurrë s'ishim zënë, kurrë grindur. Më vinte çudi kur lexoja në gazetë gjithë ato lajmërime për ndarje dhe s'kuptoja çfarë mund ta shtyjë një çift deri te një vendim i tillë, i çmendur.

Kështu deri një ditë që gjeta rastësisht në dhomën time të gjumit një bllok shënimesh të avokat Shvajcerit. Ç'donte blloku i tij aty? Ne s'kishim të



shkuar e të ardhur me të! Edhe përshëndetjen e kishim hequr. Qe e para herë që mendova keq për time shoqe, por menjëherë më erdhi turp nga vetja. Shtrydha trurin për të gjetur një arsye përse mund të gjendej (pa të keq) një bllok i tillë aty, por s'gjeta dot asnjë që ta përlligjte. Të pyesja gruan as që më shkonte mendja. Ajo më tregonte vetë çdo gjë. I ndërrova vend bllokut dhe ia lashë në një vend që dukej se ishte prekur nga dora ime. Nuk i thashë asgjë, por nisa të mos i flas. Nuk foli as ajo, nuk kërkoi, por edhe nuk dha shpjegime. Në një shtrat flinim e fjalë s'shkëmbenim. Sikur ishim nemitur të dy. Ruheshim se mos çikeshim sadopak nga frika se mos merrej si dëshirë për pajtim. Edhe kur takoheshim padashur, gjumi na dilte gjithnjë trembshëm. Nganjëherë e vëzhgoja tek flinte; më dukej vetë pafajsia e rënduar nga vuajtja. Shpesh rrëqethej në ëndërr dhe gjëmonte. Kisha dëgjuar se disa fytyra të përbindshme i hutojnë shpirtat e butë, ua mpijnë gjymtyrët me shikimin prej vampiri, dhe i bëjnë të dorëzohen pa shfaqur kundërshtimin më të vogël. Ndoshta kështu kishte ndodhur edhe me time shoqe. Por po të ishte kjo, përse nuk më rrëfehej, ajo e dinte shpirtin tim?!

Në tryezën e bukës e kisha edhe më vështirë. Djali 12 vjeçar vinte re sidomos gjestet tona në të ngrënë. Në fillim habitej shumë nga heshtja, pastaj e kuptoi që s'flisnim dhe, në vend që të pyeste, nisi t'i rrinte me turicka s'ëmës. Vetëm vaiza s'kuptonte asgjë nga zemërimi ynë dhe me fjalët e pyetjet e saj miturishte shpesh herë na vinte në gjendje të vështirë. Të hollat i lija rregullisht në shtëpi. Kur më rëndohej zemra shumë, kërkova një shkak çfarëdo dhe i telefonoja Fricit, duke i thënë se do të

vonohesha për drekë e për darkë. Gëzohesha kur më dilte ndonjë shërbim që të mos dukesha në shtëpi. Kështu vazhdoi disa kohë. Dëmi i parë i kësaj prishjeje, u pa shpejt. Nga shkolla më erdhi ankesa për djalin. Jo se bënte gjë të shëmtuar, po mungonte pa arsye në shkollë dhe kishte krijuar boshllëqe në mësimet. Sidomos kur ikja me shërbim, ai bëhej si zog i lirë e s'pyeste për njeri. E ëma që e kishte rritur e edukuar në mënyrë shembullore, tani s'ndikonte dot më, sepse im bir s'i fliste. E qortoja rëndë në sy të saj, por ai nuk përgjigjej, ulte kokën dhe vazhdonte të vetën se të vetën.

Një natë, në përvjetorin e martesës sonë, na erdhi i vëllai Ernës, me nusen e re. Që të mos e nxirrja të keqen jashtë familjes, i folë sime shoqeje sa për sy e faqe. Por ajo e mori si pajtim të vërtetë. Gjithë atë darkë i shkëlqente fytyra, fluturonte nga shendi dhe u bë copë për të na shërbyer, sidomos mua.

— Ete! merr shembull nga ime motër, — qeshi vëllai i Ernës — ka trembëdhjetë vjet martuar dhe duket më e dashur me të shoqin: se ti që je nuse e re.

Rastësisht më shkuan sytë tek im bir. Ai më shikonte në mënyrë pyetëse dhe kishte një pikëllim e hutim që s'mund ta kuptoja. Më dukej sikur thoshte: «Vërtet, u pajtuat, baba? Po unë që u ndihërova për hatër tënd ç'të bëj tani?».

Kur mbetëm vetëm në dhomën e gjumit, u vendos rishtas ajo heshtje mbylëse. Ajo priste çfarë do të bëja unë. Vështrova një copë herë tavanin dhe kur shtriva krahun të shuaja dritën e komodinës ajo më kapi për flokësh dhe më solli nga vetja në krevat.

— Po folma një fjalë, Kari! Shamë, fyemë, rrihmë, vramë, po jo kështu! Mos kështu! Të lutem! Ti po më dërrmon grimë-grimë. Shiko se si jam! — dhe më vuri dorën te barku pakëz i fryrë!  
— Ç'ke me mua?

— S'kam gjë.

— Po shikomë, pra!

M'u dhimbs dhe e përqafova. Derdha atë natë gjithë afshin tim si natën e parë të martesës, si e si ta shuaja vërragën e hidhërimit të gjatë dhe të shpija të ngrohtit në zemër. Ajo më përkëdhelte dhe s'i përmbante dot lotët e heshtur.

— Pse je kaq i butë, Karl, si engjell? Të egër, të egër, të pamëshirshëm të dua!

Po shpjegime të tjera nuk patëm.

Për të shuar të ligën që më lëvrinte nganjëherë si gjarpër, i shtova kujdeset për gruan dhe fëmijët. Mbas pajtimit, sidomos djali më shikonte çuditshëm. S'mund të them se s'i vinte mirë, por e ndieja se i ishte thyer zemra prej meje që e lashë keq. Prandaj e pajtova edhe atë me t'ëmën. Ajo e rrethoi me kujdesje dhe menjëherë u pa dora e s'ëmës: djali u bë i rregullt në shkollë.

Erdhi koha të shkonte gruaja në maternitet. E përcolla vetë. Lindi djalë dhe u gëzuan të gjithë. U gëzova edhe unë. Shkova dhe e pashë lehonë bashkë me Fricin dhe Lizën. Ata kërkuan ta shihnin vëllanë e vogël. Gjithmonë kam pasur një neveri të pashpjegueshme për fëmijët e porsalindur, prandaj nuk e zbulova nga shpërgënjtë. As ajo s'më tregoi e as bëri shaka si herët e tjera se ma dinte huqin. Vetëm thirri Lizën e Fricin mënjane dhe u tregoi një cep të fytyrës së bebes. Simbas dëshirës së Er-

nës, emrin ia vumë Viking. Megjithëse vetë s'kisha qenë Viking, më erdhi mirë për atë emër se më kujtonte Arnoldin, të cilin, shihej se ajo s'e kish harruar.

Një natë djali qau. Isha bërë më zemërdhemshur ndaj gruas, prandaj u ngrita ta lurtoj, sepse ajo kishte mbetur pa gjumë. Ajo s'desh të më linte. Kur i zbulova fytyrën shtanga në vend; një korbosh hundështypur me veshë të mëdhenj dhe push të zi; gjallë fon Shvajceri i mallkuar! Bëj ta përkund e s'më punonte asnjë gjymtyrë. Ngrita sytë nga grua-ja. Ajo ish ngritur përgjysmë me gjirin e hapur dhe flokët e lëshuar. Më shikonte mua, unë atë. Më në fund i uli sytë e s'i ngriti dot më. Ramë të dy në heshtje dhe u gdhimë duke shikuar tavanin. Edhe ferishtja, sikur ta ndiente këtë, reshti së qari. S'më ishte përtharë ende plaga e parë dhe ja ku u hap më e madhja. Tashti s'ishte më fjala për dyshime.

S'ma rrokte mendja kurrsesi ç'mund ta lidhte time shoqe me atë shëmtirë. Ç'ishte ai fëmijë i njo-më: fryt i një dashurie mëkatore, i një inarrëzie apo i një përdhunimi? Të ishte e para do t'i qëroja të dy pa lëkundje. Të ishte e dyta do t'i falja jetën dhe do t'i jepja rrugët. Sa për rastin e tretë do të qëroja fon Shvajcerin dhe do të përpiqesha ta doja Ernën, si më parë, për hir të fëmijëve dhe të dashurisë që kishim pasur.

Po ajo heshte. Ç'i kishte lakmuar vallë atij? Ç'i kishte munguar nga unë? Kushedi si e kishte futur në dorë ai maskarai. Ajo provinciale e padalë shumë, e pa rrahur me jetën mondane. Arsyje boshe. Ajo kishte pesëmbëdhjetë vjet që kishte dalë nga ferma e saj e Saarës, ishte përleshur me jetën e vdekjen më tepër se cilado grua dhe jetonte prej

kohësh në një nga qytetet më të mëdha e më të njohura të Gjermanisë duke mos llogaritur edhe angazhimin e saj si aktiviste e Partisë. Provova t'ia lë t'ajin vetes, sado që s'kishte suarë, shfaqje e festë ku të mos e kisha shoqëruar përkrahu. Sidoqoftë, duhet të kisha qenë më i kujdesshëm. Dhe prapë përkundesha në shpresa të kota se mos ishte ndonjë keqkuptim.

Përsëri nuk i fola. Por tashti nuk më mjaftonte ai kufiri i padukshëm që na pat ndarë në shtrat. Në mëngjes nxora nga sirtari i shkronjtores fotografinë e Arnoldit dhe e vara në mur, përballë shtratit tonë. U zbeh kur e pa... E dija se do ta rrëqethte kujtimi i tij, në këto rrethana. Natën e parë të martesës ajo kishte ndier si duket një ndrydhje tjetër prej pranisë së saj dhe me të drejtë më pati detyruar ta heq nga dhoma e gjumit. Tashti po e nxirrja që ta kishte parasysh për një tjetër qëllim; që ta vriste ndërgjegjja para shembëllimit të atij që e kishim pasur të dy si mësues, që e kishim dashur të dy si sytë. Le t'i tregonte ajo fotografi se ai ma kishte lënë amanet dhe ajo s'ishte treguar e denjë për të. Qysh nga ajo ditë, ajo rrallëherë ndizte dritën në dhomën e gjumit, madje vija re se edhe mugun që krijonin dritat e jashtme, përpiquej ta shuante në mënyrë që të mos e dallonte shikimin qortues që e ndiqte nga fotografia. Edhe në tryezën e bukës nisa t'i flisja më shpesh tim biri për cilësitë e Arnold Kirshes, për heroizmat e tij dhe mbarimin e tij të denjë. Dhe sa herë vinte rasti për t'i hequr vërejtjen për ndonjë send, i thosha: «Po të të shikonte dajë Arnoldi, çfarë do të të thoshte?», «Po të ishte gjallë ai, a do ta kishe bërë këtë?» Ajo nuk e duronte dot aluzionin dhe ngrihej nga

buka, gjithnjë e më e zbehtë. Më dukej vetja mizor dhe ajo e ndijshme dhe e penduar. Më dukej sikur po shpërdorja kujtimin e tij.

Gjeja një shkak e tasheparë vija nga shtabi në shtëpi. Jo për të kontrolluar gruan, as që më shkante mendja për këtë. Po u bë gruaja për ta përgjuar, kot ta mbash më. As kisha ditur ç'është xhelozia. Vija enkas për të parë Vikingun. Më rrente mendja se më kishte gabuar syri. Kur hyja në dhomën e gjumit, ajo, që sillej si hije nëpër shtëpi, më shikonte e trembur dhe përgjonte prapa portës me dridhje në zemër. Sa më tepër e vëreja, aq më shumë sigurohesha se s'ishte im bir, jo vetëm kaq, por edhe që ishte i biri i avokatit. Pastaj shaja e qortoja veten. E ku mund të tregojë fytyra e një kërthini disa javësh se i biri i kujt është? Më dukej vetja i çmendur. Pastaj përpiquesha ta përligjja për atë faj: Faji ishte imi, unë s'e kisha përgatitur për jetën moderne për rreziqet e qytetit të madh, ku, po të panë një gjë të mirë, përpiqen të ta rrëmbejnë. S'më shkante mendja për një tradhëti të ndërgegjshme, për një dashuri të ndaluar.

Djali e vuri re shpejt prishjen tonë të dytë dhe si herën e parë, nisi të mos i fliste s'ëmës. Ishte si një marrëveshje e heshtur, ku secili peshonte e vendoste vetë. Më vinte mirë që Frici ishte solidar me mua, por s'më pëlqente që ai ishte bërë kundër s'ëmës pa ditur shkaqet. Dhe, për moshën që kishte, s'më lejohej të bëja as aluzionin më të vogël kundër saj tek im bir. Secili le ta kuptonte gjendjen vetë. Vetëm Liza e vogël ndihej nëpër shtëpi. Ajo nuk kuptonte çfarë bluanim ne dhe qeshte, lozte e gëzonte, si përpara. Meqenëse ishte e lidhur mish e shpirt me t'ëmën, shërbente si ndërlidhësja jonë. Kur dë-

shironim diçka, asaj i drejtoheshim dhe secili kup-  
tonte përse ishte fjala.

Një ditë që u ktheva papritur nga shërbimi, e gjeta fotografinë e Arnoldit pak shtrembër në mur. Dukej qartë se e kishte lëvizur dikush. Më shkoi menjëherë mendja se ajo do ta kishte zbritur e do të kishte qarë mbi të. Dhe përsëri më vinte t'i shihja gjërat nga ana e tyre e mirë. Ajo ishte bërë dyllë në fytyrë, megjithëse shenja lotësh nuk i dallova. E shikova në sy kushedi pas sa ditësh dhe u mata t'i flas e ndoshta, edhe të sqarohem me të, por atë çast Frici më hyri ndërmjet dhe lëshoi një vazo porcelani të shtrenjtë që u bë copë e çikë.

— Ç'bëre kështu? — i fola, duke mos i hequr sytë nga gruaja. Ai më kërkoi të falur, dhe unë i thashë «S'ka gjë», duke bërë edhe një hap drejt Ernës. Po ai nisi të qante me të madhe, gjë që s'e kishte zakon. E pra, s'm'u duk se e rëndova. U përpoqa ta qetësoj, po ai vazhdonte të qante edhe më tepër dhe s'më lëshonte tek orvatesha të ecja drejt saj... Dhe megjithëse e fala përsëri, ai derdhte lot, pa më lëshuar krahun, si të kishte djegur shtëpinë. Kështu më humbi edhe ai çast kur mund të isha shpjeguar me time shoqe.

\*  
\*   \*  
\*

Pyeta larg e larg ndër mjekë. Dikush më tha që duheshin njëmbëdhjetë muaj që foshnja të merrte tiparet e veta të mirëfillta. Ndoshta inati, mëria, xhelozia më bënë ta shihja ndryshe. Po cili priste dot aq muaj nën një strehë me gruan e pabesë dhe

fëmijën e huaj? Në gjithë jetën time kisha pasur vetëm dy dashuri: familjen e detyrën... Tashti po zbuloja se bota s'ka vetëm dy gjëra. Në mosinteresi-min po shihja dhe ndëshkimin tim.

E ndava mendjen. Edhe në ato rrethana e doja gruan aq shumë, sa që s'më sinkonte mendja ta bëja me turp. Veç kësaj, — dhe kjo ishte kryesorja — a më lejonte zemra t'u vija njollë fëmijëve të mi duke i hapur nam të lig s'ëmës? S'dëshiroja kurrësesi që fëmijët të merrnin vesh se kanë pasur një nënë të pandershme që ua ka ndarë ose vrarë i ati dhe kanë rjënë vëlla me babë të huaj. Mendoja për një zgjidhje që të mos njolloste asnjërin dhe të mos i ngjallte askujt as më të voglin dyshim. Nuk lëkundesha nga frika e jetës sime. Por duhej të zhdukeshim të dy në mënyrë që të mos na përfliste kush. Mendova të hidhja helm në gjelë, por hetimet me këtë rast do të zgjateshin dhe do t'ia vinin gishtin dikujt. Veç kësaj, duhej të mendoja për fëmijët që ishin fryt i dashurisë së pastër. Më parë duhet t'i mësoja si të jetonin e të rriteshin me nder. Nisa t'i jap rrogën Fricit, ta mësoja të bënte s'penzimet e shtëpisë. Në fillim e tërhiqin xhinglat, por më vonë nisi të përparonte. Të hollat i linte në një vend të caktuar dhe në fund të muajit diçka edhe tepronte. Kisha frikë mos më prishej djali, se shkolla prapë po më ankohej për mungesat, por derisa me të hollat ishte shumë i rregullt, e hoqa atë kujdes.

Në sytë e botës, nuk jepnim të kuptonin asgjë, dilnim në shëtitje, sado që rrallë, për vizita dhe në rrallë, gjithmonë me fëmijët në mes, po përpjekje për shpjegime nuk patëm kurrë. Sa dëshiroja ta kisha djalin të rritur që të mund të më kuptonte si duhej! Por më vonë mësova se im bir s'kishte



pritur vitet që të piquej. Le që fëmija që ka hyrë në të trembëdhjetat kupton shumë gjëra.

Një herë, tek po laheshim në plazhin e lumit Main, sesi m'u dha e kapa time shoqe për flokësh dhe e zhyta në ujë me forcë. Dhe do ta kisha mbytur pa ngurrim, sikur të më kundërshtonte sadopak, por ajo qëndroi nën ujë si e vdekur me sytë e qelqtë të ngulitur tek unë, sikur thoshin: «Ku je moj vae-kje e bardhë! Hë, bëje ç'ke për të bërë, vetëm sa më parë»!

Atë çast, vajza ime, që e donte fort, duke mos e parë nga bregu, thirri:

— Mami! Mami!

Dhe unë u lëkunda dhe e lëshova. Erna nuk shpejtoi të dilte, sikur ajo që e priste jashtë ishte më e tmerrshme se ajo që kishte parë nën ujë.

Në shtëpi tashmë kishim bërë një ndarje jo-zyrtare po të vetvetishme. Gruaja nuk vinte më në dhomën e gjumit, po flinte në dhomën e fëmijëve, me Lizën dhe Vikingun që gugaste gjithë ditën pa ditur se ishte bërë personazh i rëndësishëm në dramën tonë. Unë me Fricin flinim në dhomën e gjumit. Sa për të tjerat, ishin si më parë.

Një herë vajtëm te vëllai i Ernës për një ditë-lindje. Sadoqë u përpoqëm ta fshihnim, ai e vuri re ftohtësinë tonë dhe kur u gjendëm veçan më pyeti. I bëra lak fjalës, por ai s'm'u shqit e ma nxori me grep. Ia tregova të gjitha pa ligësi. Bëra më tepër fajtor veten se sa atë, dhe e biseduam punën vëllazërisht.

— S'gjete njeri tjetër të dyshojë? Me atë përbindësh të shkojë ime motër?!

— Kjo më bën prej muajsh të ngurroj. Po blloku i shënimeve të Shvajcerit, s'më le rehat.

— E qysh do t'ia bësh?

— Ta pyes e kam të vështirë.

— As unë nuk mundem.

Po kur erdhi e pa djalin, më dha të drejtë.

Në ditët e më vonëshme vura re se Erna ishte çuditërisht e gjallëruar. Shoqërohej edhe me ca gra që hynin e dilnin në apartamentin tonë. Ishin të gjitha aktiviste naziste dhe lëvizjet e tyre dukeshin të natyrshme për kohën. Ato ditë papritur më erdhi dhe vjehrra nga Saara. Kam thënë se ajo ishte grua e sertë prandaj nuk dëshiroja ta inerrte vesh punën, pa marrë rrugë si duhet. E pyeta për nënë Helenën, por ajo më tha se nuk e kish takuar prej shumë kohësh... Që të mos binin në sy marrëdhëniet e mia me Ernën, gjithë atë javë fjeta në shtab.

Vendosa më në fund të takoj nënë Helenën dhe pastaj t'ua shpjegoj dy plakave hallin tim dhe t'i jap njëfarë zgjidhjeje. Kisha gati pesë vjet që s'e kisha parë. Thashë se kisha menduar për vështirësitë që prisnin fëmijët në të ardhmen, prandaj me atë rast vendosa t'i njoh me vendlindjen dhe kushtet e jetës së fshatarëve të mi. Sa herë im bir, kur i tregoja për Arnoldin, më pati lutur të venim të shihnim varrin e tij. Unë kisha në krahinën e Folkligenit, jo shumë larg Cvajbrykes, një shtëpi dhe një vresht që e administronte një kushëri i largët. Me atë pasuri dhe me ato pak të holla që kisha kursyer mund të siguroheshin disi fëmijët. Thashë pra, të dal një herë familjarisht anëj. Vitet e para kisha qenë dhe e kisha parë nënën e Arnoldit mot për mot, po pastaj, qoftë nga detyra, qoftë nga natyra ime isha kufizuar duke i dërguar ndonjë kartë postale a ndonjë pako me vogëlima. Se po e përsëris, që gjithë jeta ime ishte shtëpia dhe detyra.

S'kisha asnjë shok civil. Bisedat e mia silleshin veç për armë, lejë shtabesh, alarme, organizime. Familjes i kisha krijuar kushte të mira. Përpiqesha të mos interesohesha fare se ç'bëhej rrotull. Jo se isha symbyllur, por sepse oficeri i Vermahtit, duhet ta ketë si natyrë të dytë mosmarrjen me politikë. Unë kisha dashur që Saara të bashkohej me atdheun tim dhe ajo u bashkua, kisha dashur që trupat franceze të shporreshin nga krahina e Rinit dhe ato i shporrëm, kisha qenë kundër traktatit të Versajës dhe ai ishte kthyer në një lëvere. Për të tjerat, s'më takonte mua të mendohesha, për atë kishim Fyhrerin tonë. Atë kishte ngarkuar Gjermania të udhëhiqte, le të udhëhiqte, mua me shokët më kishte ngarkuar të përgatis popullin për luftë, për këtë përpiqesha ditë e natë. Vërtet më kishin rënë në sy disa teprime në politikën tonë, por gazetat gjenin gjithmonë argumente për t'i përlligjur. Më 30 qershor 1934 në «Natën e thikave të gjata» qeshë tronditur tepër. Më se njëmijë e pesëqind anëtarë me përgjegjësi të reparteve të sulmit, bashkë me shefin e tyre të shtabit, ministrin Rem, u vranë pa gjyq. Edhe trajtimi mizor që u bëhej çifutëve nuk më pëlqente, por nuk isha i zoti të gjykoja mbi vlerat e argumenteve që paraqiste kundër tyre Fyhreri ynë. Thashë se përpiqesha të mos vija re se ç'bëhej rrotull meje, por edhe padashur njeriu vëren.

Një të shtunë, mëngjes herët, i mora të gjithë dhe u nisëm për në fshat, në Saarë. U thashë se do të shihnim pronën tonë të vogël. Meqë s'flisja me Ernën, s'e pashë të nevojshme t'i tregoja se do të ktheheshim edhe nga nënë Helena. Djalin e madh e kisha për krah. Erna me Lizën rrinin prapa. Korro-

ziun e vogël ia kishim lënë vjehrrës që ndenji në shtëpi. Morëm autostradën e Jugut që në të lerë të diellit, kaluam shpejt Darmshtatin dhe kur ndoqëm brigjet e Rinit e ngadalësova shpejtësinë se Frici kishte qejf t'i shpjegoja çdo gjë që shihte. Në Manhajn kaluam Rinin dhe atëherë e shtova shpejtësinë për të arritur sa më parë në Saarën tonë. Papritur, më lindi ideja të përmbysëm me veturë. I jepja si i çmendur, i merrja kthesat pa ulur marshet dhe rrotat shpesh kërkëllitnin në hava. Unë e vëzhgoja Ernën në pasqyrë dhe përpiqesha të zbuloj një shenjë frike, një shenjë alarmi, një shenjë përgjërimi në fytyrën e saj, por më kot. Vetëm sytë e saj e kishin humbur kaltërsinë dhe ishin bërë të hirtë. Tiparet i kishte të ngrira. Madje, në cepat e buzëve mezi zbulohej një nënqeshje mospërfillëse që bëhej më therëse kur kapsalliste sytë. Kisha dëshirë të mos vdiste e qetë, ta ndiente fajin, por si ta mësonte i paudhi, ajo nuk turbullohej. Kur arrita afër një humnere e shtova shpejtësinë në kulm, i vendosur të gremisem poshtë. S'kishte gjë më të thjeshtë. Të nesërmen në gazeta do të dilte një lajmërim i shkurtër ku të tregohej se si pasojë e një aksidenti automobilistik gjeti vdekjen Major Karl Landau me të shoqen dhe dy fëmijë.

Im bir, si të ma kuptonte mendimin, shtrëngonte dhëmbët dhe pëshpëriste me gjithë shpirt.

— Jepi, babi, jepi fort, fort!

Por në kulmin e tensionit, dëgjova vajzën e vogël që thirri:

— Baba, na rrëzove! — dhe e pashë të strukej në gjirin e s'ëmës. Nervat e mia s'duruan më dhe preva timonin mu në buzë të gremenës. Pjesën tjetër të rrugës e bëra me shpejtësi normale dhe të

gjithë u shkriferuan. U ndalëm disa minuta në Saarbyrken, pastaj hipëm në makinë përsëri. Sa dolëm nga qyteti, im bir më pyeti se ku do të venim më parë.

Para së gjithash, do të vemi te varri i Arnoldit, — i thashë Fricit.

Ime shoqe, që një orë më parë po i buzëqesh-te vdekjes, tani u bë si shkumësi në fytyrë. Mezi hapi buzët e tha:

— Lizë, — gjithmonë i fliste vajzës, kur duhej medoemos të më thoshte diçka — Lizë, unë nuk jam mirë. Dua të zbres, të shkoj në Flagchov (Ashtu quhej ferma e Valdeve).

Gjithnjë kam qenë mëndje mbushur se ajo kishte një dobësi të veçantë për kujtimin e Arnoldit që ndikonte për mbarë në natyrën e saj.

Ndërrova rrugë pa folur dhe e shpura në fermën e saj. Si pushuam nja dhjetë minuta, mora fëmijët dhe u nisa për Cvajbryke. Por meqë ura e vjetër ishte shembur, na u desh të linim veturën e të bënim më se një orë në këmbë. Natyra ishte në lulëzim dhe ne i morëm të përpjetat e kodrinave pa përtesë. Rrugës kisha frikë se mos më thoshin fëmijët «u lodhëm, duam të kthehemi!» dhe gjithnjë i shihja në sy se mos dalloja shenja dobësie — se s'ishte çudi t'i kishin bërë për vete rehatia, bulevardi, ledhat, — por ata për fat të mirë erdhën në qejf dhe këtu ndiq një flutur, aty këput një lule, më tutje ha ferrëmana, iu afruam stacionit të Cvajbrykes. Edhe nja dy herë që desha ta marr Lizën në krahë s'më dëgjoi se donte të bënte vastakë me lule.

U ndalëm te varri, po varri nuk ishte më aty; vetëm një gur përkujtimor ku shkruhej:

«Arnold Kirshe — 1896-1923 — Luftëtar për Lirinë e Gjermanisë, vrarë nga dora e pabesë e... B-a-u-n-a-n-ë-v-e».

Mezi lexohej fjala e fundit se një dorë e ligë kishte lyer me bojë të zezë emrin e vrasësve, Baumanëve, pa arritur ta shuante. Një dorë e mirë kishte kruar me thikë atë bojë, pa arritur ta hiqte krejt. Kjo purë duket se ishte përsëritur dy tri herë, pa arritur asnjëra dorë ta kryente punën deri në fund. U inatoso me ata Baumanët e ndytë. Kishte hak fon Shvajceri. Ç'ka lind nga macja, gjuan minj! Kishin kaluar katërmëdhjetë vjet e më shumë atë, plaga s'më ishte mbyllur. Po ato gërmadnat e tymosura të Baumanëve atje poshtë, ma shëronin disi zemrën. Pyeta një kalimtar për varrin. Më tha se para ca kohe i kishin ngritur eshtrat dhe varrosur me luftëtarët e tjerë në Saarbryken. Pyeta për nënë Helenën dhe ai më tha se banonte ende në fshatin e vjetër, ndërsa shumica e familjeve kishin zbritur poshtë:

— Si punët e të çmendurve — e mbylli fjalën ai.

— S'është e çmendur! — kundërshtova unë.  
— Mos e ngatërroni me ndonjë tjetër?

Ai turzi kokën për «jo» dhe vazhdoi rrugën e vet.

Kur arritëm atje, pamë se fshati i vjetër, pothuajse ishte shkretuar. Dukej se plaka nuk shkulej prej andej, se jetonte me kujtimet e birit të vetëm.

Kur hyra në shtëpi, mezi e njoha, kaq ishte rrëgjuar e gjora në krahasim me pesë vjet të shkuara. Vetëm fytyra e rrefkët më kujtonte atë të dikurshmen. Po përziante një kusi në zjarr e po fliste me vete. Më shikoi si e hutuar në fillim, por kur

e thirra me emër, u hodh e më përqafoi me lot në sy. Solla vështrimin rreth e rrotull e s'më zuri syri gjë të saktë. As shtresa s'pashë e s'mora vesh ku flinte. Qulli bënte pllaq plluq në kusi. Na ftoi të hanim drekë. Ma donte zemra të pranoja, por shikova fëmijët. Kisha frikë mos përvilnin buzët. E falenderova dhe u ulëm. Na vuri nga një misur përpara.

— Pse nuk më ke shkruar, moj nënë? — i thashë, por nga ana tjetër qortoja veten. Urë e kisha ndihmuar në fillim, pastaj e kisha lënë në harresë. Ajo kishte shumë të afërm dhe çuditesha qysh e kishin lënë ashtu.

Na hodhi nga ai qull me të cilin isha rritur, po që s'e kisha provuar qëkur. Gjithnjë u tutesha fëmijëve se mos shfaqnin ndonjë pakënaqësi, por ata ishin lodhur nga rruga dhe hanin me shije, pa naze. Isha mëdyshaz, ta hap bisedën për të birin, apo jo. Kisha nevojë të flisja për shokun tim, por kisha frikë, mos ia rëndoja shpirtin më tepër. Biseduam për gjëra të ndryshme, kur ajo papritur me një fytyrë të shtrembër më tha:

— Ruaju, Karl! Ruaju bir, mos të të gjejë si Arnoldin tim!

E kuptova merakun e saj dhe i thashë se tashti ishim të lirë e të sigurt në sajë të tij dhe djemve të tjerë që kishin dhënë jetën.

— Të lirë, të lirë, po shiko, mos të të vrasin. Ja, këtu pas koke... me një plumb të vetëm, — dhe me gishtin e thatë preku pas veshit, sa më erdhi të rrëqethur.

Kishte qenë e vërtetë ajo fjala që më tha i panjohuri se plaka kishte lajthitur. Dhe befas m'u kujtua ai krahasim i bukur për zemrën e nënës dhe

zemrat e shokëve pas vdekjes së të hirit të vetëm. Tashti po e shikoja se zemra e saj me kalimin e kohës, jo vetëm ishte zezuar krejtësisht, por edhe kishte plasur, rdërsa imja... Vërtet a kisha bërë sa duhej për kujtimin e tij?

I thashë se ai kishte rënë si burrat dhe fajtorët e kishin paguar, më tepër madje.

— Ah, jo — kundërshtoi plaka — unë s'kam asgjë me Baumanët. Më sëmbon në zemër kur i kujtoj. Ata e kanë dashur gjithmonë të shuarin.

Nuk e ngava më tej se m'u mbush mendja top se ajo kishte kaluar fare. Frici, që e kish ëndërruar prej kohësh këtë takim, dëshironte ta pyeste për shumë gjëra, por sa hapte gojën, unë, ose i terhiqja vërejtjen për ndonjë send, ose i bëja me shenjë, deri sa e kuptoi se s'duhej ta zgjaste bisedën. Pastaj, plaka sikur u kthjellua dhe u interesua për familjen time, për gruan dhe fëmijët. Dhe kur më pyeti se sa fëmijë kisha, pa u mendur iu përgjigja:

— Dy!

Djali nuk bëri zë, por Liza ndërhyri.

— Kemi edhe një bebe të vogël që e quajnë Viking.

— Ah, Viking!? — thirri plaka si e tërbuar. — Ku ia paskeni gjetur këtë emër ogurzi.... Edhe mua, Vikingët ma hëngrën djalin. Po Erna, si nuk erdhi asnjëherë, apo ka frikë mos e vrasin si tim bir?

E pashë se kishte shkalluar krejt.

— I ngatërron gjërat, nënë — e kundërshtova butë. — Ajo nuk vjen se ende i pikon zemra gjak nga kujtimi i Arnoldit. Edhe sot u mek kur ia përmendëm, dhe sa për Vikingët...



— Mos të dukem e çmendur? — më ndërpreu ajo.

— Ç'është ajo fjalë, nënë Helena! Por m'u kujtua një gjykim i thellë dhe i bukur që më ke pas thënë dikur për zemrat e nënave. E shoh se paske pasur të drejtë. Por nuk është mirë të mbash mendjen gjithnjë në një vend, se pastaj, dashur pa dashur të kthehet në fiksasion, në mos më keq.

— Fiksasion, the?! Ç'është ajo fjalë! Ke fjetur ndonjëherë përmbys?

— Sigurisht!

— Të është zënë fryma?

— Edhe të zihet, nënë, por njeriu kthehet mbarë dhe...

— Kur ty për një orë, t'u zika fryma, po im bir që ka ndenjtur përmbys kaq e kaq vjet në varr, a merr me mend se sa ka vuajtur? Ke dëgjuar të varroset njeriu përmbys në ndonjë vend të botës?

— E pamundur! — bërtita dhe angushtia ma zuri frymën.

— Përmbys dhe me një vrimë plumbi këtu, pas kokës. Ja këtu... — dhe plaka shtriu gishtin të më prekte pas kokës.

Deri atë ditë, pandehja se jam pak kurajoz, por kur ndjeva gishtin e plakës që kërkonte diçka pas veshit tim, m'u bë trupi miza miza e u ngrita Djali s'bënte zë, veç hapte sytë herë nga unë, herë nga plaka e gjorë.

I kërkova të falur dhe i thashë të nisesha se më priste ime shoqe. Ajo më luti t'ia sillja një herë Ernër se kish për ta pyetur për diçka me rëndësi që nuk mund të ma thoshte as mua. Më vetëtiu në mendje se mos kishte dëgjuar ndonjë fjalë për pri-

shjen tonë. Iu përgjigja se ajo ishte e sëmure dhe iu luta të vinte nja një muaj tek ne në Frankfurt.

— Edhe ajo do të gëzohet edhe ty do të të hapen sytë njëherë. Nuk rrihet gjithnjë duke menduar zi. Veç kësaj, edhe unë kam nevojë për ndihmën tënde, — shtova.

— Ajo s'ka ardhur asnjëherë — tha ajo — kurse unë s'mund të lëviz se pres ca letra. Pastaj do të shëtis, ndoshta do t'i bie kryq e tërthor Gjermanisë... Po, si thua, a do të kishte shkuar Erna mirë me tim bir po të ishte gjallë? — e ktheu përpitur ajo, si e kanë zakon të çmendurat.

— Patjetër, — iu përgjigja i zënë ngushtë.

— Po ju, a shkoni mirë — vazhdoi ajo.

— A është pyetje për t'u bërë kjo? — i drethova dhe hoqa sytë nga vështrimi i tim biri se më erdhi turp.

— Edhe unë ashtu mendoja. Kur ju martova më dukeshit si dy engjëj. — Kalojnë vitet, o bir! A do të më sjellësh, pra Ernën?

Diçka i premtova dhe i lashë lamtumirën. Prapë më luti të prisja një çast. Vrapoi te një sepet dhe nxori një shami të mbështjellë. E çpështolli mënjënjë fëmijëve dhe më pyeti.

— E njeh çfarë plumbi është ky?

— Kolt! — i thashë si e vërejta.

— Sa larg vret Kolti?

— Si ta marrësh. Zakonisht është për të qëlluar nga afër.

— A mund t'arrijë, ta zëmë, nga shtëpia e Baumanëve deri te vendi ku u vra i shuari?

— Ndonjë plumb qorr edhe mund të vrasë.

— Im bir ecte drejt shtëpisë së tyre për të kaluar matanë. Si... po ne jse... Të falem nderit, —

tha mëdyshas dhe e palosi plumbin në shami me kujdes.

Edhe duke u ndarë u përpoqa t'i vidhem dorës së saj të thatë që kërkonte me ngulm një birë në rrashtën time.

Gjithë ajo shëtitje e këndshme na u kthye në zymti. U kthyem shpejt e shpejt, dhe, pa e ditur përse, dredhova rrugë e nuk i rashë nga guri për-kujtimor i shokut, as nga shtëpia e djegur e Baumanëve. E lashë vizitëz që desha të bëja në shtëpinë time, vajta mora gruan në fermën e saj dhe u nisëm për në Saarbyrken, ku do të kalonim natën.

Rrugës në timon, bisedoja me djalin që të dëgjonte ime shoqe. Kuptohet, nuk përmenda asnjë çartallosje të plakës, vetëm se i qava hallin dhe i thashë se ishte hutuar pak. Përsërita nja dy herë se donte të takohet me shoqen e dikurshme të të birit. Duke folur kështu e duke ecur ngadalë, dora më shkoi vetvetiu prapa kokës dhe më erdhi të kërktoj një vend të shpuar në kafkën time. Po im bir më solli në vete:

— Baba, ç'bën ashtu?

E hoqa dorën sikur të ma kishin zënë në xhepin e huaj dhe i dhashë veturës shpejtësi si e si ta heq atë përshtypje të kobshme. Por biseda s'u lidh më. S'kishim bërë ndoshta as dy kilometra kur dora më vajti përsëri aty. Dhe vajza më kujtoi, e më kujtoi keqas.

— Baba, përse thonte nënë Helena se e kanë vrarë dajë Arnoldin pas koke?

Atë çast dëgjova një klithmë prapa meje dhe pashë Ernën në pasqyrë që çakarriti sytë dhe pastaj u pak. Ndala veturën dhe e ndihmova të vinte

në vete. Ia njoma gojën me konjak dhe i fërkova tëmthat.

Pas kthimit në Frankfurt vura re se u shtuar vizitat në shtëpi. Hynin e dilnin ca gra të njohura në rrethet tona. Midis tyre ishte edhe e shoqja e vëllait të një gualajterit të njohur nazist. Po nuk u vura rëndësi. Sado që vija rrallë, vura re se tashti që kishte të ëmën në krah, gruaja nisi të çonte hundën përpjetë. Hunguronte pa pushuar nëpër shtëpi.

Një ditë më thirri komandanti i qytetit, brigadenfyhri Shtaube. U hodha një sy problemeve për të cilat mund të më kërkonte llogari dhe u paraqita. Sa hyra në zyrën e madhe, më ranë në sy anash një tryeze të gjatë të shkëlqyer ato ngjallicat që hynin e dilnin në shtëpinë time, të veshura të gjitha me këmisha të murrme, me mëngë të përveshura dhe me svastikën e stamposur në sfondin e zi të rrumbullakët. U habita dhe desha të dal por sekretari më tha të qëndroja. Brigadenfyhri Shtaube, ndryshe nga herët e tjera, kishte marrë një hije të rëndë dhe më foli me një ton të rreptë zyrtar.

— Ju kemi thirrur për të shqyrtuar qëndrimin tuaj të padenjë në familje. Nga disa anë na kanë ardhur ankesa për çthurjen tuaj morale gjë që ndikon për të keq edhe në mbarëvajtjen e jetës së bashkëshortes dhe fëmijëve tuaj. Fyhreri na porositi që të rrisim fëmijë të shëndoshë e të fortë, ushtarë të vërtetë për luftën e ardhme që do të tregojë epërsinë e racës ariane. Po në qoftë se prindërit do të kenë marrdhënie të kalbura, çfarë mund të presim nga fëmijët? Zonja juaj nuk është ankuar, por njerëzve tanë — dhe u kthye nga ato

gratë për të marrë një shikim miratues — u ka rënë në sy sjellja juaj e shëmtuar. Keni kohë, ndoshta vite, që nuk i kryeni detyrat tuaj bashkëshortore, shpirtërore e materiale, duke dhënë kështu një shembull të keq që s'i ka hije oficerit të Vermahtit. Ju paralajmërojmë për këtë, ju kërkojmë shpjegime dhe ju ftojme për të fundit herë të ndërroini rrugë. Ndryshe!...

Një herë u habita, pastaj u tërbova, pastaj u frenova dhe u hodha një vështrim përbuzës atyre dosave që më ishin kapardisur anash tryezës së gjatë që vetëtinte. Dhe kur gjenerali i tha fjalët kërcënuese (tamam si të mos më rrihte e të mos e njihja) unë s'durova më, tërhoqa një karrige pa marrë leje dhe pa nderuar. Madje, edhe vura këmbën mbi këmbë. Si të mos mjaftonte kjo, nxora dhe kutinë e duhanit dhe drodha një të fortë.

— Kujtova se më thirre për detyrën. Tjetër gjyq prej teje s'njoh! — i thashë harbutçe.

Ai u mpi njëherë, shikoi anash, pastaj nisi t'i përtypte fjalët. I nxori ato gratë jashtë mori një herë frymë thellë dhe më pyeti miqësisht si e kisha punën.

— Fare thjeshtë — i thashë, — ime shoqe më ka vënë brirë. Dhe jo vetëm kaq, por unë po rris dobiçin e botës. Dhe, si të mos mjaftonte kjo heshtja ime, tashti dashka edhe ta lavdëroj publikisht për këtë që ka bërë.

— Në qoftë se keni baza për këtë akuzë, detyrohem t'ju kërkoj ndjesë. Dhe më falni që jam përzier në punët tuaja personale. Megjithëse ju duhet ta kuptoni se nuk varet gjithçka nga unë, që ta themi hapur, shumë pak... Po, në qoftë se nuk e keni të rëndë, a më lejohet t'ju pyes?

I tregova fill e për pe historinë. Më dha të drejtë, por shikimi i tij kërkonte të dinte edhe emrin. Dhe kur i thashë se cili ishte armiku im, brigadenfyhneri u trondit shumë. Ndaj emrit të fon Shvajcerit nuk mund të qëndronte indiferent asnjë funksionar i qytetit dhe pa e tepruar, edhe i kryeqytetit. Nuk më la të dilja, po thirri komandantin tim, kolonelin Hofman. I tha shkurtimisht se kisha ca halle të rënda familjare dhe e porositi të mos më ndahej kurrkund.

Të nesërmen më erdhën dy padi gjyqësore. Në njërin paditesha për një shuplakë që i paskështa rënë gruas (më akuzonin mua, që, e shumta e shumta, e kam shikuar vranët!) Tjetra ishte për ndarje. Paditesha se nuk sillesha mirë, nuk kryeja detyrimet bashkëshortore, e përdorja gruan si skllave, harboja me çupat studente gjatë stërvitjes etj. Mund ta kuptoni habinë time kur i lexoja. Kujtova se e bënin për t'u tallur e për të më trembur.

Gjyqi i parë që i thjeshtë, ulur në një tryezë si miq. U lexua akuza. Si prova u paraqitën deklaratat e vjehrrës dhe gruas. Ngrita supet dhe mohova me buzë në gaz. Thashë se ato s'kanë qenë në vete kur i kanë nënshkruar dëshmitë, por nuk e shtyva më tej. Meqë emri im s'ishte ndier kurrë për të keq në qytet, gjykatësit që më njihnin të gjithë sado që më cilësuan fajtor, më dhanë dënimin më të lehtë, disa marka gjobë.

S'do të isha dukur fare në shtëpi, por më vinte keq për djalin dhe shkoja ndonjëherë. Tashmë hanim veç e veç.

Erdhi dita e gjyqit të dytë. E kryesonte seancën një gjykatës i njohur, Sheferi. E njihja qëkur, dhe pa qenë shokë, kishim një përshëndetje të përzemërt.

E përshëndeta edhe atë ditë si herët e tjera, por ai s'm'u përgjigj.

«E po, detyra, — thashë. — Nuk dëshiron të duket i anshëm».

— Ulu aty! — më foli gjykatësi rëndë. Fytyra e ngrirë po më çudiste.

Përsëri pashë se bankën e dëshmitarëve e kishin mbushur ato gratë që kishin qenë edhe në komandë. Në mes tyre shquhej ajo kunata e atij gaulajterit të rëndësishëm.

Kurrë s'kisha dëgjuar gjyqe. As e dija se si bëheshin. Desh harrova. Në fillim, kisha dëgjuar për gjyqin e djegies së Rajhshtagut, i cili kishte përfunduar keq. Por ne na thanë se fajtorët kishin shpëtuar, sepse hetuesit kishin qenë të pazotë, prokurorët të trashë dhe gjykatësit liberalë. Dhe raste të tilla nuk do të përsëriteshin. . . E pranoj se ishte faji im që s'interesoheja për këto gjëra. Kisha besim të verbët në çdo gjë zyrtare. Nisesha nga mendimi që secili kryen detyrën ashtu si e kryeja unë timen.

U lexua padia. Në fillim, prapëseprapë s'dëshiroja ta njollosja time shoqe botërisht dhe u përgjigjesha pyetjeve me dy kuptime. Thashë se akuzat jo vetëm s'ishin të vërteta, por edhe të çuditshme. Shtova se gjatë gjithë jetës sime bashkëshortore kisha qenë shumë korrekt dhe padija duhet të ketë qenë fryt i një gjendjeje të acaruar nervore ose i një shtyese të ligë.

Fjalët e mia i morën si një dobësi. U ngritën ato bushtrat me radhë dhe më sulmuan me një mijë gjëra të paqena. Po kur u ngrit Erna dhe përsëriti po ato fjalë, s'durova dot më:

— Dëshironi t'i biem shkurt? Djali i vogël s'është i imi. Është i avokat Shvajcerit. Unë nuk pranoj të rris doçin e botës, prandaj më sulmojnë me shpifje.

Fjalët e mia ranë si bombë. Në sallë u bë pë-shtjellim i madh. Gjykatësit shikonin majtas e djathtas. Kryetarit i shpëtoi zilja nga dora tek për-piqej të vendoste qetësinë. Seanca u mbyll në vend. Trupi gjykues vendosi: Ndërgjyqjësit dhe fo-shnja të bëjnë analizat e gjakut.

Ç'ishin këto grupe gjaku tashti? Pyeta, hapa enciklopedinë, libra mjeksorë dhe kriminalistike. Desha, s'desha i mësova emrin një farë Landshtaj-neri, shkencëtar austriak, i cili paskësh bërë zbuli-min e këtyre grupeve.

Qysh prej kohësh që s'mbahen mend, kish lin-dur nevoja t'u merrej gjak njerëzve të shëndoshë e t'u jepej atyre që kishin humbur gjak me shumicë për shkak hemorragjish të rënda. Por shumica e transfuzioneve kishin përfunduar me vdekje. Shumë ishin shkruar për këtë fenomen, por asnjë përfun-dim i sigurtë nuk ishte arritur. Thuhej shkurt se gjaku i personave të ndryshëm në shumë raste ishte i papajtueshëm. Por ajo që e ngatërronte më tepër punën ishte se mjaft njerëz kishin marrë gjak dhe kishin mbetur gjallë e shëndoshë, pra gjaku i tyre pajtohet me atë të dhuruesit. Si e pse nuk dihej. Si të gjendej që më parë se cili gjak ishte i pajtue-shëm me marrësin? Shkencëtari austriak, pas ekspe-riimentesh të gjata, kishte arritur në përfundimin se gjaku i gjithë njerëzve të rruzullit ishte katër llojesh, të cilat i quajti konvencionalisht A, B, AB dhe 0 (ze-ro). Po të hedhësh gjakun e grupit A tek një epru-vetë me gjak. A, nuk vihet re asnjë turbullim. Pra,



ka pajtueshmëri. Kështu edhe B pajtohet me B etj. Por po të përzieësh gjak të grupit A me gjak të grupit B në epruvetë shohim një turbullim dhe për pak kohë, po të vëresh në mikroskop dallon se rruzat e kuqe janë ngjitur me njëra tjetrën grumbuj-grumbuj (fenomeni i aglutinimit) dhe sedimentojnë. Ndërsa serumi i gjakut mbetet i pastër. Kështu ndodhte turbullimi edhe po të përzieje grupet e tjera me përjashtim të grupit O që ishte indiferent dhe nuk shkaktonte aglutinim me cilindo grup gjaku që përzihej. Nga ky zbulim i madh i shpëtuan vdekjes qindra, mijëra njerëz. Mjaftonte që dhuruesi i gjakut të ishte i grupit O ose i të njëjtit grup me marrësin dhe njeriu ishte i shpëtuar. Po në Evropë, megjithëse zbulimi u bë herët, pak kush u interesua për shkencëtarin e madh, madje as u muar vesh rëndësia e zbulimit të tij. Atëherë u gjëndën amerikanët që e ftuan, i krijuan kushte të shkëlqyera pune e jetese dhe ndihmuan ta çonte më tej veprën e tij shkencore. U zbuluan edhe nëngrupet e gjakut. Më 1930 Landshtajnerit iu dha çmimi Nobel. Mbas mjeksisë, për këto grupe u interesua edhe kriminalistika. Në saje të analizës së gjakut të gjetur në gjurmët e krimiit u zbuluan shumë faktorë, dhe u shkarkuan nga akuzat shumë të pafajshëm. Një fushë e gjerë e zbatimit të analizës së grupeve të gjakut u hap edhe në drejtësi, në problemin e njohjes së atësisë së fëmijës. Duke u bazuar në faktin se fëmija trashëgon nga gjaku i prindërve, në bazë të një formule të përcaktuar qartë, përputhja konsiderohej si provë ndihmëse në përcaktimin e atësisë. Po kështu, nga mospërputhja e grupeve, me anë të metodës së përjashtimit, përcaktohej me siguri mosnjohja e atësisë. Kështu po të jenë

prindërit të grupit O dhe B, fëmija del i grupit B ose O dhe nuk del i grupit A dhe AB. Po formulat e tjera janë edhe më të ngatërrueshme. Sa më tepër futesha në studimin e problemit të vështirë të grupeve aq më tepër më lëshonte zemra. Mundësitë për të provuar fjalën time ishin aq të pakta sa i humba shpresat. Po sikur unë e fon Shvajceri të kishim të njëjtin grup? Vetëm fati mund të më ndihmonte.

Ditën e caktuar shkua në laborator unë dhe gruaja me foshnjën. Revolverin e kisha marrë në xhep. Kisha vendosur që në çastin kur gjaku i Vikingut nuk do të kombinonte me timin dhe do të përputhej me atë të fon Shvajcerit, do ta vrisja avokatin në vend. Po për çudi, armiku im s'kishte ardhur. Pyeta dhe më thanë se s'kishte ndonjë vendim gjyqi për ta thirrur atë.

Sapo e morën vesh përse kishim ardhur, laborantet e reja u mblodhën tubë. Sollën disa epruveta me gjak. Në të parën shënohej se kishte gjak të grupit A. Në të dytën B e me radhë. Së pari më morën gjak mua e prej tij hodhën disa pika në epruvetën A. Gjaku i epruvetës u turbullua. Hodhën në të dytën, u turbullua përsëri, ndërsa në të tretën s'ndodhi gjë. Pra, unë kisha gjak të grupit AB.

Sollën një grup tjetër epruvetash. I morën gjak gruas. Po me atë ç'kishin? Unë nuk kundërshtoja që ishte biri i saj. Si e trashëgonte fëmija grupin e nënës? Kisha harruar, më ishin ngatërruar në kokë tërë ato që kisha lexuar gjatë atyre tri ditëve. Ajo doli e grupit O.

I erdhi radha foshnjës. Prisja me gjak të ngrirë. Dikush më tha se mjaftonte që djali të kishte gjak të

grupit A dhe B dhe konsiderohej imi. Në bazë të këtij ligji, qindra miliona fëmijë të grupeve A dhe B që gjenden nëpër botë, mund të m'u bëkan ngar-kim. Kësaj i thonë të të mbetet kopili në derë. Kur i morën gjak Vikingut ky klithi dhe shtrembëroi hundët. M'u duk tamam si turiri i fon Shvajcerit kur më takonte në rrugë. Më parë, se tashti kishte kohë që s'dukej gjëkundi.

Hodhën gjakun e fëmijës në epruvetën e parë, nuk u turbullua. Unë fshiva djersët. Hodhën në të dytën, prapë s'u turbullua. Shamia m'u bë ujë. As në të tretën s'ndodhi gjë, as në të katërtën, ç'po ndodhte?

— Grupi O! — thirri laborantja.

— Mirë? — pyeta.

— Keq! — tha ajo.

— Si keq? — Si keq? — thirra.

Ajo pa nga ime shoqe. Atë çast vajzat e laboratorit duke ngulur thonjtë në faqe e duke kafshuar buzët shihnin nga Erna. Mora frymë i lehtësuar. Vetë zoti po më ndihmonte të dilte në shesh e drejta ime! Unë s'u kisha thënë gjë, por ato e dinin nga praktika përse bëheshin analiza të tilla, leqë mund të ishte hapur fjala nëpër qytet.

Erna shtrengonte nofullat dhe shihte ngultas diku në mur, gati për t'u hepuar. Përsëri m'u dhimbs dhe i futa krahun që të davarisja dyshimin e laboranteve. Kam pasur zemër të butë. Dikush mund ta quajë këtë dobësi, por mua s'më ka ardhur kurrë keq që s'kam lindur i egër. Po të më ishte rrëfyer, mund ta kisha mëshiruar. Por heshtja e saj më torturonte mbi çdo gjë. Kishte kaluar kaq kohë dhe ende s'po kuptoja nëse ai fëmijë ishte fryt

i një dashurie mëkatore apo i një marrëzie të pakuptueshme. Përpara se të prisheshim ajo gjithnjë fliste me rrëqethje për shëmtimin dhe shtazërinë e fon Shvajcerit. Por kohët e fundit, komandanti im, koloneli Hofman më kish dhënë të lexoja një roman të Hygoit (kurrë s'i kam dashur e gjithmonë i kam çmuar këta francezët) ku tregohej për një femër të bukur të cilën e tërhiqte deri në çmenduri shëmtimi fizik, shtazëria shpirtërore. Mundet që kështu kishte ndodhur edhe me time shoqe, e cila në fytyrë përgjasonte me një engjell. Gjithë këto mendime m'u sollën në tru tek zbrisja shkallët. Por sa dolëm te porta ia hoqa krahun se më dukej pa kuptim.

Kur vajta herën tjetër në gjyq, gjykatësi Shefer më foli ndryshe, më butë. Shihej se kishin ndikuar për mirë rezultatet e analizave të gjakut. Seanca që e shkurtër. Pala paditëse kërkoi të përsëriteshin analizat. Unë kundërshtova se e pashë me dyshim atë orvatje.

— Analizat vërtetuan qartë se foshnja s'është imja. Tani kërkoj që fon Shvajceri t'u nënshtrohet të njëjtave analiza dhe do të shikoni se ato nuk do ta përjashtojnë nga atësia.

Ma kundërshtuan fjalën duke thënë se nuk kishte asnjë bazë mbështetëse për të ligjëruar thirrjen e avokatit të nderuar para gjyqit.

— Pse, — kundërshtova unë, — nuk mjaftoka fytyra për të përcaktuar qartë i kujt është fëmija? As në racën time, as në të paditëses nuk gjendet korrozi i tillë. Hunda e shtypur, veshët ilapushë, flokët e zinj kokoridh si të zezakëve. Vikingu është gjallë i ati. Dhe, megjithëse në konferencat e tij fon Shvajceri tregohet si përkahës i zjarritë i racës aria-

ne, po të kërkojë thellë ndër shtërgjyshat, ndoshta do t'i duhet të udhëtojë tutje nga Afrika. Shikoni fëmijët e mi, sytë e kaltër, flokët ngjyrë gruri. Dhe jo vetëm ata, por edhe prindërit e tyre edhe gjyshet e tyre nga nëna dhe babai këtë pamje kanë.

U çua peshë gjithë salla. Shokët e mi që gjendeshin aty pranë nga ana e dëshmitarëve dhe paditëses qeshën me zë.

— Të mos përmendet me qëllim përulje emri i një njeriu të nderuar në qytet dhe që ka luftuar e punuar aq shumë për kauzën e Gjermanisë!

Gjykata vendosi të përsëriteshin analizat. Kërkesa ime që të thirrej fon Shvajceri për analiza, nuk u pranua dhe seanca u mbyll. Në shtëpi gjeta një letër nga nënë Helena. Ajo më kujtonte përsëri fjalën që i kisha dhënë për ta çuar Ernën në fshat. Thoshte se ka nevojë të ngutshme për të biseduar me të. Dhe në rast se nuk mund të vinte ajo, më porosiste mua që ta pyes se cili ishte ai Vikingu i Madh dhe ku mund ta gjente se donte të sqarohet edhe një herë për ata Baumanët e gjorë (prapë ato fiksasionet e plakës së shkretë).

Kuptohet që unë s'flisja as takohesha më me gruan, prandaj iu përgjigja menjëherë duke i kërkuar të falur që s'ia kisha dërguar Ernën dhe e lajmërova me pikëllim se ime shoqe më kishte dalë e pabesë dhe fëmijën e fundit e kishte me njëfarë avokati fon Shvajceri. I shkrova se jo vetëm gjaku, por edhe fytyra tregonin qartë se s'ishte imi. E mbvlla letrën me këto fjalë: «A mban mend, nënë Helena, të ketë pasur në racën e Valdeve ndonjë korbosh hundështypur dhe veshllapush? Të pyes sa për të hequr merakun se, kur shoh foshnjën, sikur kam turirin e avokatit para syve».

Edhe analizat e dyta, që kësaj radhe i bëmë në maternitet, dolën njëlloj, domethënë se djali s'kishte lidhje me mua. Nuk e kishin të lehtë të më bënin ndonjë mashtrim, se kisha shumë shokë aso kohe që nuk mund të shkeleshin me këmbë:

Po gjykata arbitrarisht vendosi prapë të bëheshin analizat. Dukej sheshit që dikush e mbronte time shoqe dhe donte të fitonte kohë për ta nxjerrë të larë bashkë me fon Shvajcerin, i cili nuk dukej gjëkund.

Këtë ia thashë në formë proteste gjykatësit.

— Mos përmendni emra! Mos çënoni nderin e të tjerëve! — më kërcënoi Sheferi.

E respektoj qëllimin tuaj të mirë për të mbrojtur nderin e të tjerëve, dhe pres gjithashtu të mbrojni edhe nderin tim nga veprat e liga të të tjerëve! — iu përgjigja.

Edhe analiza e tretë dhe e fundit doli në favorin tim. Kur u ktheva në zyrë gjeta përsëri një letër të nënë Helenës. Por ishte si nata me ditën, ndryshe nga e para, me shkronja të mëdha, të bëra si me këmbë pulash nga një dorë e dridhur.

«Biri im.

Sikur të më kishe treguar më parë për hallet e tua familjare ndoshta do ta kishim lehtësuar shumë njëri-tjetrin. Por ti s'ke dashur të më brengosësh dhe unë hutaqja s'kam arritur deri sot të kuptoj se në vend të pëllumbeshës të paskam futur në gjinj një gjarpër. Dhe në qoftë vetëm një, gjysma e së keqes. Dhe, sikur të kisha pará biri im, do t'ua ngrija shtëpinë atyre Baumanëve të gjorë dhe do të ngrija meshë për shpirtrat e tyre. Njerëz të Perëndisë kanë qenë të gjithë. Të lutem shumë, përgjigju menjëherë, ajo «kukulla» që e di vetë, mos i ka flokët

kaçurrela të imët, me ngjyrë të zezë, ngjitur pas kokës? Dhe mos harro të ruhesh, Karli im, dhe të kujdesesh për atë vendin prapa kokës... Dhe të më tregosh se sa larg vret Kolti... Dhe shtyje deri në fund të muajit gjyqin se pres disa shkresa e s'vij dot...».

Këtë radhë jo vetëm u rrëqetha, por edhe u shqetësova nga fjalët e plakës, urtësi, mall nëne, mister, çmenduri përzier bashkë. Vetëm u çudita shumë se nga e dinte ajo qysh i kishte Vikingu i vogël flokët dhe ç'i duhej pöhimi im.

Megjithatë i shkrova menjëherë përsa më kërkonte. Sadoqë më dukej pakuptim, kërkova edhe shtytjen e gjyqit deri të hënën tjetër.

Por as të hënën në mëngjes nënë Helena s'kishte ardhur. Ia lashë çmedurisë së saj të gjitha ato llafe të letrës dhe u nisa për në gjyq. Avokati im më tha se çështja tashmë ishte e fituar dhe më pyeti për sanksionet pasurore që duhet t'i vinim palës tjetër. Por mua s'më dukej burrërore të përfitoja nga rasti dhe e porosita të mos kërkonte kushte të rënda.

Kur u hap seanca, ia dhanë fjalën avokat Funkes, vëllait të gualajterit të njohur. Ky qenkësh kryetar i degës juridike të bashkisë së Frankfurtit. S'po kuptoja në emër të kujt fliste e ç'kërkonte. Ai kishte sjellë një piring me libra të trashë dhe herë pas here tregonte me gisht drejt tyre ose hapte vendet e shënuara e lexonte citatë. E nisi me eiozhe për veprën shkencore të Landshtajnerit, shpjegoi teorinë e tij dhe nisi arsyetimet mbi vlerën mjekoligjore të zbulimeve të tij. Jo ky grup, jo ai grup, jo qëllon kështu, jo qëllon ashtu, jo ndodh që edhe mund të gabohemi, jo s'ka gjë të prerë me thikë,

jo shkenca nuk paskësh fund dhe zbulimet pasonin njëri tjetrin e tjerë, e tjerë.

E pashë se po zgjatej e po i dridhte arsyetimet për të dalë e kundërta e atyre që kishte pohuar në fillim. U mbusha me sofizmat e tij dhe u ngrita.

— Përse qenkan analizat e gjakut atëherë i nderuar zoti jurist? Sikur të kishin dalë rezultatet siç dëshironit ju, a do të kishte mbetur varur vendimi i gjyqit siç ka mbetë? Përse nuk e përmendni problemin e përjashtimit që është abecejja në administrimin e provave? Përse e ka marrë Landshtajneri çmimin Nobël, ju lutem? Mos vallë, na ka vërtetuar se grupet e gjakut janë një paragjykim? Sipas arsyeveve tuaja të ndritura, foshnja duhet të kishte përputhje gjaku me mua për t'u quajtur i Shvajcerit. Apo dëshironi të ishte flokëverdhtë e sykaltër si fëmijët e mi, që të provohej se është biri i atij Shvajcerit zijosh.

Po gjykatësi Shefer qëndronte i pandijshëm ndaj fjalëve të mia. Si u bëri edhe ca pyetje «dëshmitarëve» kërkoi të thirrreshin fëmijët. Frici dhe Liza hynë të topitur nga gjithë ajo sallë dhe ata njerëz hijerëndë. Po shpejt, Liza pa të ëmën dhe buzëqeshi. Frici më pa mua e më erdhi pranë. Gjykatësi i tha të afrohej dhe e pyeti.

— Po qe se e sjell puna që të ndahet baba nga nëna, me cilin dëshiron të jetosh?

— Me atë që të fitojë gjyqin, dhe të drejtë ka baba, — tha djali duke e parë në dritë të syrit Sheferin.

Të them të drejtën më erdhi mirë për atë përgjigje.

— Përse paska të drejtë babai? — pyeti me një të qeshur therëse gjykatësi.



— Sepse nëna fliste fshehtas me një njeri që i kishte bërë keq babait.

— Po pse foli, ç'u bë? Me sa njerëz na bie rasti të flasim edhe pse s'i duam?

— Po ajo në sy të babait e shante, ndërsa unë e pashë një herë që erdhi fshehtas tek ne, kur babai ishte me shërbim.

— E pastaj?

— A nuk mjafton kaq zoti gjykatës?

— Kuptohet që nuk mjafton.

— Unë atëherë nisa të mos shkoj rregullisht në shkollë dhe sillesha nëpër shtëpi. Babai nuk fliste më me nënën.

— Domethënë të kishte porositur babai të spiunoje nënën, — bëri presion Sheferi.

U binda që gjykatësin e kishin shkelur me të holla. Po djali ngriti kokën krenarisht.

— Ju lutem të flisni me respekt për atin tim, zoti gjykatës. Ai nuk di gjë për këto dhe të tjerat që do të them.

— Nuk ju kam thirrur këtu që të dëgjoj shpjegimet tuaja! — i tha rëndë gjykatësi — përgjigju pyetjes dhe shko!

Por djali u mbajt si burrë i pjekur.

— Ju më pyetët vetë «përse ka të drejtë babai» dhe unë po ju përgjigjem, sigurisht, nëqoftëse nuk ju shqetësoj.

Sheferi u detyrua t'i bjerë ziles një copë herë për të shuar zhurmën e admirimit nga salla.

— E po, vazhdoni, de, por shkurt!

— Sa herë që kthehej babai nga shërbimi, dëgjonte ankesa nga shkolla për mungesat e mia dhe më qortonte rëndë. Unë e dëgjoja kryeulur, por nuk mund t'ia shpjegoja shkakun e mungesave të

mia. Nuk ndiqja nënën — nënën e dua dhe e nderoj, — por përpigësja të mos i lija rast atij njeriu të keq për të ardhur tek ne. Me këtë veprim besoja se i bëja mirë si nënës ashtu dhe babait. Pas ca kohësh u pajtua dhe ashtu bëra dhe unë. Për disa muaj e vazhdova shkollën në rregull. Por një ditë, pak kohë pasi lindi Vikingu, vura re se nëna e babai ishin prishur përsëri. Atëherë im atë nxori së pari fotografinë e Arnoldit dhe e vuri në dhomën e gjumit. Dhe unë përsëri, pa më porositur njeri, nisa të mos shkoj në shkollë dhe të rrija ku rrinte nëna. Jo ta spiunoj, po ta mbroj. Një ditë nëna i tha Lizës, se ne flisnim nëpërmjet motërzës, se po bëhesha vonë për shkollë. Thashë se isha i sëmurë e nuk do të shkoja. Më luti më tepër se zakonisht dhe mua m'u shtua dyshimi. Sa më tepër që kalonte koha aq më shumë shqetësohej nëna. Herë hynte në një dhomë, herë në një tjetër, shikonte tasheparë orën dhe hapte e mbyllte dritaret kot-sëkoti. Po më shumë hynte në dhomën e gjumit, ku ndodhej krevati i foshnjës. Dikur, nëna i foli Lizës me përgjërime që të venim në farmaci për të blerë një ilaç për Vikingun se ishte shumë sëmurë. Desha, s'desha, u nisa. Nëna nisi edhe motrën e vogël pas meje. Por sa zbrita shkallët, e ktheva motrën mbrapsht, duke e porositur të mos lëvizte nga apartamenti. Vrapova sa munda, po u vonova pak. U ktheva pa frymë, dhe nisa t'i ngjisja shkallët dy nga dy. Me atë turr që kisha marrë për pak u përplasa me atë njeriun e lig që po zbriste si i çmendur shkallët tona. Vura re se ishte shpërfytyruar krejt sadoqë atë në çdo kohë të ditës a të natës ta shikoje, trembte edhe shejtanin. Hyra fill në dhomën e gjumit dhe e gjeta nënën të zbehtë tek

përkundte në gji foshnjën që qante. Ajo ktheu shpinën se dukej shumë e shqetësuar edhe vetë. Dola andej dhe vajta kapa Lizën. «Kush ishte këtu? — e pyeta.» Ishte doktori i zi për të parë Vikun. Kështu më tha nëna. E dëgjova kur thërriste «Hopa Viking», «Hopa Viking» dhe qeshnin të dy. Pastaj; papritur, se ç'pati që i bërtiti nënës, theu një xham, dhe iku duke përplasur derën» — më shpjegoi Liza. U ktheva prapë në dhomën e prindërve dhe e gjeta nënën tek varte fotografinë e dajë Arnoldit që ishte rrëzuar për tokë. Copat e xhamit ishin shpërndarë nëpër qilim. Ajo përpiqej ta vendoste pa e shikuar, por ajo rrinte shtrembër.

«E ngatërroi me fotografinë time», thashë unë me mend.

Por ajo gjë i ra në sy edhe gjykatësit që pyeti: — Mos deshët të thonit fotografinë e babait?»

— Jo, jo! — u përgjigj Frici — ai kishte goditur fotografinë e dajë Arnoldit, ndërsa të babait, s'e kishte prekur.

Mua përsëri më erdhi çudi. E mbaja mend punën e fotografisë së lëvizur nga vendi, por nuk kuptoja ç'mund të kishte fon Shvajceri me shokun tim të vranë.

— Atë ditë — vazhdoi Frici — edhe babi u kthye papritur nga shërbimi. S'e di përse, ai dukej shumë zemërdhemshur dhe donte të pajtohej me nënën. Unë, domosdo, nuk dëshiroja t'i tregoja atë që dija, por as ta lija të pajtohej, prandaj sa u drejtua nga nëna, i dola përpara, theva një vazo të shtrenjtë dhe duke u shtrirë sikur po qaj, e duke iu lutur të më falte, e pengova.

— Mjafton! — e ndërpreu gjykatësi, — me cilin dëshiron të shkosh, me nënën a me babain?

— Me atë që ka të drejtë, e të drejtë ka babi.

— Të drejtën e përcakton gjyqi, Mirë shko!  
— dhe duke u kthyer nga sekretari — shënوني se djali don të shkojë me atë që do të fitojë gjyqin. Vajza tha se dëshironte të shkonte me të ëmën. Kuptohet që Liza që e vogël.

U pyetën palët dhe avokatët, nëse kishin gjë për të shtuar pasi do të jepej vendimi. Avokati im pyeti si ishte puna e dëshmisë që kishte kërkuar të bënte Helena Kirshe, ndërmjetësja e martesës sonë. Gjykatësit bënë një copë herë pësh-pësh dhe pastaj Sheferi deklaroi se dëshmia e saj s'kishte të bënte fare me çështjen, veç kësaj i mungonte çdo lidhje logjike, gjë që vërtetonte se plaka e nderuar nuk ishte në gjendje normale. Aq më tepër që, sipas të dhënave të gjykatës, e quajtura Helenë Kirshe, gjendej e shtruar për kurim në klinikën psikiatrike «Erdman» të Frankfurtit. Kjo e bënte të pavlefshme dëshminë e saj.

Unë isha hutuar krejt nga këto të papritura, Funke me «teoritë» e tij, djali me ato që më zbuloi, dhe tashti çështja e Helena Kirshes në thonjtë e spitalit psikiatrik më bënte të mos e kapja kohën që kaloi sa u përgatit vendimi. I dëgjoja fjalët e rënda të Sheferit i trullorur e s'po kuptoja për cilin listë.

«Tronditja e rëndë e marrdhënieve bashkëshortore... të bëhet shembull për oficerët e tjerë të Vermahtit... djali dhe vajza, sipas kërkesës së tyre i jepen për edukim nënës... Alokacion... Apartamenti përkohësisht derisa të gjejë banesë tjetër....

As unë nuk e di se si vajta në çmendinë. Komandanti s'mu nda kurrkund. Nuk na lejuan të futeshim brenda. Përtej kangjellave dukeshin të çmen-

duriit që shëtisnin kryqetërthor oborrit krejt të çarrafilluar. Luta, thirra, kërcënova. Dikur, ma nxorrën plakën në një dritare. S'kishte mbetur as gjysma e saj. Flokët e thinjur e të shprishur i vareshin mbi sy. Sa më pa, klithi thekshëm.

— Ruaju, o bir! Ruaju të them! Nuk jam e çmendur. Më mbajnë kot, Arnoldin tim e kanë vrarë prapa koke. E kanë varrosur përmbys. E di ç'do të thotë të rrish përmbys në varr dhjetra vjet me radhë? Ke fjetur ndonjëherë përmbys? Merre me mend të jesh edhe i mbuluar me dhe? E di cili është fon Shvajceri yt? Është Vikingu i Madh! Zijoshe me hundë të shtypur, me veshët llapush dhe flokë zezaku. Ai e ka vrarë tim bir nga pas me një plumb të vetëm. Plumb kolti. Nuk e kanë vrarë Baumanët. Atë natën e zezë, ata s'kanë qenë fare në shtëpi. Ishin në një dasmë në Shulc. Ia kam dërguar dokumentat gjyqit. Edhe fotografitë e dasmës. Kërko dokumentet, o Karl, kërkoji se mua s'më lenë të dal. Se kush u bë sebeb e më futën në çmendinë vetëm se kam fshirë emrin e Baumanëve nga murana e Arnoldit...

Dhe ruaje vendin prapa koke...

Dikush e tërhiqte plakën nga pas, por ajo mbahej në pezulin dhe thërriste me zë të shqyer. Kur u zhduk ajo, komandanti më tërhoqi edhe mua për krahu dhe hipëm në veturë. E ngiste ai. As më fliste, as më shikonte por dukej i pezmatuar. Padashur më shkoi dorë prapa kokës, sikur të kërkoja diçka. Atë çast edhe komandanti Hofman ngriti dorën dhe m'u duk sikur kërkonte po atë vend, Edhe njerëzit rrugës sikur kërkonin nga një vrimë pas koke... gjithë qyteti, gjithë Gjermania.

S'dija ku isha, Shkuam në zyrë. Tashmë nuk ishte puna për të zhdukur gruan dhe veten, siç mendoja një herë e një kohë. Turpi ishte bërë. Turpi dhe krimi. S'duhej fshehur po zbuluar. Por s'gjendeshin veshë për të dëgjuar, as sy për të parë. Tashti dureshin qeruar hesapet me atë të ligun që futej si gjarpër në jetët e njerëzve dhe kafshonte tinëzisht. Duhej bërë hakmarrje e tmerrshme. Po ai se nga e kishte thyer zverkun. Jo, ai përgjonte. Por do ta përgjoja edhe unë Vikingun e Madh.

U ula dhe shkrova një letër të gjatë. Atë çast m'u kujtua djali. Nga shpjegimet e tij në gjyq, kuptova se përse e kishin të dy bashkëfajtorët frikë fotografinë e Arnoldit.

Ç'bënte tani djali, vetëm në atë shtëpi të huaj? Mora leje. Koloneli Hofman që ishte i zënë ma mbajti revolen. Ia lashë me dëshirë nga frika se mos bëja gjë para kohe nga gjaknxehësia.

Djalin e gjeta te shkallët. Sa më pa m'u hodh në qafë. Nuk donte të rrinte me të ëmën. Nga porta kishin shkukur pllakën me emrin tim. Frici më tha të hyja në dhomën e fëmijëve. Gjeta një dhomë të shkretuar, një krevat ushtarak portativ, ca rroba të bëra sukull, ca plaçkurina, enë dhe libra të hedhur grumbull. Muret ishin zhveshur nga çdo gjë, sikur të ishin dyndur vikingët në shtëpinë time.

Rregullova diçka me duart që më dridheshin. Gjithnjë mendoja si të laja hakun. Kisha qenë naiv gjithë jetën. S'më kishte vajtur mendja një herë t'i shikoja gjërat edhe nga faqja tjetër. Pashë se mungonte fotografia e Arnoldit dhe u nisa në dhomën e gjumit për ta marrë. E vetmja gjë që ishte hequr aty, ishte fotografia. Dola dhe vajta në kuzhinë. Trokita. Doli gruaja serbes.

Ç'farë do këtu? — thirri. — Jashtë! I pabesë.

M'u errën sytë. Kisha përpara një fytyrë krejt tjetër nga ajo që kisha dashur me shpirt. Si kishte qenë e mundur të kalonte një jetë të tërë me maskë! E kisha marrë vajzë të re nga fshati, shkolluar, hapur sytë dhe ajo më vuri brirë me atë bishë që më kishte zhdukur shokun (madje, mund ta kishin zhdukur bashkë) më grabiti fëmijët, më nxori nga shtëpia, më ngarkoi edhe fajin, dhe tani po më quante të pabesë. Pashë një satër ngulur në një dru, në kuzhinë. E mbërtheva dhe desha t'i bie kokës. Atë çast sulmoi vjehrra dhe më doli përpara. Iu përmblodha asaj një herë, dy-tri, derisa ra lëmuç për tokë. Pastaj kapa gruan për leshrash. Por tashmë nuk më bënë sytë dritë. E qëllova në tym. Pandehja se po i bija ballit, por ajo paskësh venë dy duart mbi kokën dhe po mbrohej. Kur e pashë se u mbyt në gjak dhe u var si e vdekur, kujtova se i erdhi sosja dhe e lëshova. Fqinjët shpërthyen derën e më hoqën andej. Kur pa grumbullin e njerëzve ajo, që s'qenkësh dëmtuar rëndë, u ngrit dhe duke vënë ulërimën u vërsul drejt ballkonit. E ndoqa, po kaq isha habitur sa s'dija përse po e ndiqja, të mos e lejoja të thërriste, apo ta hidhja poshtë. Ende nuk e di. Por prapë ma hoqën nga duart. Dhe vetëm kur më ftoi dikush që ta shoqëroja m'u kullua mendja dhe e kuptova se kisha lënë kryesoren pa bërë.

Dhe s'kisha për ta bërë kurrë».

Burrel. shtator 1977

---

Vikingët — popull barbar nordik i njohur për egërsinë e tij.

(The text in this section is extremely faint and illegible, appearing to be a series of lines of handwritten or typed text.)

Tirazhi: 15.000 kopje      Formati: 70x100/32

Shtypur: Poligrafia «11 Shkurti» — Tiranë



α. 25.